

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 E hënë, 4 tetor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Dhomat e Specializuara të Kosovës çelin seancën. Uluni ju

8 lutem.

9 Mirëdita. Znj. Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: Të nderuar Gjykatës mirëdita. Kjo

11 është lënda KSC-BC-2020-05. Prokurori i Specializuar kundër

12 Salih Mustafës.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit. Së pari të prezantohen palët të cilët janë të

15 pranishëm. Znj. Prokurore, mund të na thoni se kush është i

16 pranishëm për Prokurorinë.

17 ZNJ. D'ASCOLI:[Përkthim] Patjetër të nderuar Gjykatës.

18 Mirëdita. ZPS-ja paraqitet sot nga Zëvendës-Prokurori i

19 Specializuar, Alex Whiting, Prokurori Cesary Michalczuk,

20 Ndihmës-Prokurori Filippo De Minicis, Menaxhere e Lëndës Julie

21 Mann dhe Silvia D'Ascoli.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Mbrojtësja e Viktimave.

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 mirëdita të gjithëve. Mbrojtësja e Viktimave si ekip
2 përfaqësohet sot nga Marie-Pier Barbeau, Ndhmëse Ligjore
3 Kryesore, Liesbeth Segveld, Bashkëmbrojtëse dhe unë Anni Pues,
4 Mbrojtëse e Viktimave. Faleminderit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës.
8 Mbrojtja përfaqësohet nga z. Betim Shala, Bashkëmbrojtës, unë,
9 Julius von Bone, Hetues dhe Përkthyes Fatmir Pelaj.

10 Z. Mustafa na bashkohet përmes videolidhjes.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Z.
12 Mustafa, funksionon lidhja në rregull? Na dëgjoni?

13 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, shumë mirë, e
14 nderuara Gjykatëse.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
16 shumë mirë. Për procesverbalin ky proces drejtohet nga Trupi
17 Gjykues Nr. 1. Përpara se të fillojmë me dëshminë e
18 Dëshmitarit 01679, dëshiroj që të diskutoj një çështje me ZPS-
19 në. Znj Prokurore, ZPS-ja ka dorëzuar një kërkesë për pranim
20 provash nga bërja e pyetjeve nga pala thirrëse të dëshmitarëve
21 W03593 dhe W04600. Dy dëshmitarët e parë të ZPS-së që Trupi
22 Gjykues vëren se ZPS-ja paraqet për t'u pranuar në prova të
23 gjithë transkriptin e deklaratave të UNMIK-ut dhe intervistave
24 të ZPS-së, të cilat janë përdorur pjesërisht gjatë dhënies së
25 dëshmisë në Gjykatë të dëshmitarëve W03593 dhe W04600.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Gjithashtu kemi vënë re se ZPS-ja paraqet për t'u pranuar në
2 prova në tërësi deklaratën e Dëshmitarit W03593 të datës 3
3 qershor 2021. Kjo nuk është përdorur gjatë bërjes së pyetjeve
4 të dëshmitarit në sallën e gjyqit. Trupi Gjykues dëshiron që
5 të sqarojë se vetëm ato pjesë të intervistave të cilat janë
6 diskutuar me dëshmitarët gjatë dhënies së dëshmisë së tyre në
7 Gjykatë para Dhomave të Specializuara mund të paraqiten për
8 t'u pranuar në prova nga palët dhe Mbrojtësja e Viktimave. Kjo
9 është në përputhje me parimin e dhënies së dëshmive gojarisht
10 që parashikohet në rregullën 141(1) të Rregullores. Asnjë prej
11 përjashtimeve që parashikohen në ligj dhe në rregullore nuk
12 janë të zbatueshme në këtë rast. Duhet që të mbajmë parasysh
13 faktin që pjesë të deklaratave të mëparshme, të cilat nuk janë
14 përdorur gjatë dhënies së dëshmisë së dëshmitarit në Gjykatë,
15 dhe nuk mund të paraqiten për t'u pranuar në prova se bihen
16 ndesh me këtë parim të dhënies së dëshmive gojarisht që
17 parashikohen në Rregullore dhe me të drejtën për gjykim të
18 drejtë.

19 Trupi Gjykues gjithashtu sqaron se në përputhje me e
20 vendimin e pranueshmërisë së provave, Trupi Gjykues i udhëzon
21 palët dhe Mbrojtësen e Viktimave që të dorëzojnë materialin e
22 gjatë në tërësi për t'i dhënë mundësi Trupi Gjykues që të
23 vlerësojë kontekstin. Por kjo nuk mund të interpretohet ama se
24 autorizohet paraqitja për t'u pranuar në prova edhe të
25 deklaratave të mëparshme me shkrim të dëshmitarëve, apo pjesë

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 të tyre, të cilat nuk janë përdorur në Gjykatë.

2 ZPS-ja pra duhet të mbajë parasysht, duhet të rimendojë
3 ridorëzimin e kërkesës për pranim në prova. Duke dorëzuar për
4 t'u pranuar në prova, vetëm ato pjesë ekzakte që janë përdorur
5 në Gjykatë. Nga ana tjetër, në mënyrë alternative, ZPS-ja mund
6 të dorëzojë parashtrime të tjera shtesë përse mendon se mban
7 qëndrimin e mbajtur në paragrafin 5 të kërkesës së vet duke
8 përcaktuar dhe bazën ligjore.

9 Znj. Prokurore unë mund t'jua jap fjalën tani nëse
10 dëshironi, por mundet edhe më vonë, në një moment tjetër në të
11 ardhmen, kur t'i kthehem, në vartësi të diskutimit që do të
12 bëjmë, do të shikojmë se si do të ecim.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Patjetër të nderuar Gjykatës,
14 faleminderit që më dhatë fjalën. Hë për hë mund të them se e
15 mbajtëm shënim dhe do të paraqesim parashtrime. Ne siç e
16 thashë, e mbajtëm shënim, do ta ridorëzojmë kërkesën dhe nëse
17 është e nevojshme do të dorëzojmë tërësinë e pjesëve të cilat
18 nuk do të përdornim.

19 Faleminderit.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit. Po në këtë rast, unë do të jap një urdhër
22 gojarisht. Trupi Gjykses i kërkon ZPS-së që të dorëzojë brenda
23 ditës së premtë, 8 tetor 2021, kërkesën për pranim të provave
24 nga bërja e pyetjeve të dëshmitarëve të vet me numër W03593
25 dhe W04600, duke dorëzuar për t'u pranuar në prova vetëm ato

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 pjesë ekzakte që janë përdorur në Gjykatë. Trupi Gjykues i
2 rikujton Mbrojtjes dhe Mbrojtjes së të Akuzuarit, më falni,
3 dhe Mbrojtjes së Viktimave për mundësinë për të dorëzuar
4 përgjigje për këtë mocion brenda afateve kohore të
5 parashtruara në Paragrafin 41 të vendimit për pranueshmërinë e
6 provave.

7 Këtu mbyllet urdhri i dhënë gojarisht.

8 Atëherë të kalojmë tani me programin për sot. Është
9 dëgjimi i dëshmisë së dëshmitarit W01679. I lutem shoqërueses
10 të shoqërojë dëshmitarin të hyjë në sallë.

11 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
13 Dëshmitar, mirëdita. Mirë se erdhët në Dhomat e
14 Specializuara. Më dëgjoni?

15 DËSHMITARI: Po, po, po dëgjoj, veç zëni shumë i vogël.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
17 tani më dëgjoni më mirë?

18 DËSHMITARI: Më mirë është, po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse
20 duhet ngritur dhe pak volumi i zërit mund ta ngremë dhe më
21 shumë.

22 Ky është maksimumi. Po, në rregull, he për he. Si jeni
23 pikësëpari?

24 DËSHMITARI: Mirë, faleminderit. Pak emocione kam. Mirë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kuptoj, e kuptoj. Do përpiqem që të shpjegoj gjithçka se çfarë
2 do të bëjmë sot në sallë bashkë me ju për ta lehtësuar paksa.

3 Do të fillojmë sot me dëshminë tuaj. Përpara se të filloj
4 kam disa gjëra me rëndësi për t'ju thënë. Së pari dua t'ju
5 shpjegoj masat mbrojtëse të cilat janë miratuar për dhënien e
6 dëshmisë tuaj. Ju është caktuar një pseudonim. Kjo do të thotë
7 se emrin tuaj nuk do ta përmendim asnjëherë këtu në sallë.
8 Gjithmonë do t'ju quajmë z. Dëshmitar. Në këtë mënyrë publiku
9 nuk do ta marrë vesh emrin tuaj. Do të zhvillojmë punimet me
10 shtrembërim të fytyrës dhe të zërit tuaj, që do të thotë që
11 personat jashtë kësaj salle të cilët e shikojnë transmetimin
12 nuk mund të ta shikojnë fytyrën dhe nuk mund të ta dëgjojnë
13 zërin e vërtetë.

14 Kur t'ju përgjigjeni pyetjeve të cilat nuk ua zbulojnë
15 identitetin, këtë do ta zhvillojmë në seancë të hapur, siç po
16 veprojmë tani. Të gjithë na shikojnë neve por jo ju. Por kur
17 do t'ju bëjnë pyetje që të përshkruani diçka, e cila në mënyrë
18 të veçantë lidhet me ju, apo përmenden fakte që kanë të bëjnë
19 me ju direkt, këtë do ta zhvillojmë në seancë private. Kjo do
20 të thotë se nuk do të ketë transmetim të seancës private. Çka
21 do të thotë se jashtë sallës së gjyqit, askush nuk e dëgjon
22 atë që ne do të themi këtu brenda. E vë re që po pohoni me
23 kokë.

24 Pra, nëse thuhet ndonjë gjë në seancë të hapur e cila
25 mund të të identifikojë do ta mbrojmë këtë informacion.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Dëshmia juaj transmetohet me vonesë, që kështu ne mund të
2 eliminojmë çdo informacion nga transmetimi. Po kështu ky
3 informacion mund të hiqet edhe nga transkripti publik i
4 procesit.

5 Krahas këtyre masave mbrojtëse, janë miratuar dhe katër
6 masa të tjera shtesë për ju, me kërkesë të Zyrës së Mbrojtjes
7 dhe Mbështetjes së Dëshmitarëve. Zyra e Dëshmitarëve siç i
8 themi shkurt, në përputhje me Rregullën 80(4)(c)(i) dhe (iii)
9 të Rregullores. Këto masa të posaçme janë si vijon, është
10 mbrojtja me perde që të mos ju shikojë drejtpërdrejtë i
11 akuzuari, miratimi i pauzave me kërkesën tuaj ose nëse janë të
12 nevojshme, prania e një psikologu gjatë dhënies së dëshmisë,
13 si edhe ndihma brenda Gjykatës, brenda sallës më falni nga një
14 anëtar i stafit mbështetës. Dhe për këtë, pra edhe psikologu
15 dhe ndihmësi do të jenë në dispozicion nëse do të keni nevojë
16 gjatë dhënies së dëshmisë.

17 Ky vendim i Trupit Gjykses u është vënë në dispozicion
18 palëve dhe Mbrojtjes së Viktimave me email në datën 28
19 shtator. Z. Dëshmitar, janë të qarta këto masa mbrojtëse?

20 DËSHMITARI: Po. I kuptova.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
22 Nuk është nevoja ta përmend dhe këtu u drejtohem palëve dhe
23 Mbrojtëses së Viktimave, por edhe anëtarëve të Trupit Gjykses.
24 Dua ta përmend edhe njëherë që duhet të kushtojmë vëmendjen
25 maksimale për këto masa mbrojtëse, në mënyrë që të shmangim

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 gjatë bërjes së pyetjeve, nxjerrjen e informacionit
2 konfidencial në seancë të hapur. Kjo është diçka për të gjithë
3 ne.

4 Ju rikujtoj se kjo seancë zhvillohet në seancë të hapur,
5 nëse nuk kërkohet ndryshe nga palët, apo nga Mbrojtësja e
6 Viktimave, apo nga Trupi Gjykses. Në këtë kuadër, ju rikujtoj
7 që të më njoftoni paraprakisht nëse kërkoni të kalojmë në
8 seancë private apo të mbyllur me qëllim të bërjes së pyetjeve.
9 Ju kujtoj palët dhe Mbrojtëses së Viktimave që të zbatojnë
10 procedurën, më falni, për të kërkuar redaktimin në Gjykatë
11 sipas vendimit të marrë. Në fund fare ju rikujtoj edhe njëherë
12 procedurën e zakonshme të Gjykatës sa i takon mënyrës që
13 flisni.

14 Z. Dëshmitar, tani ju kthehem edhe njëherë juve. Ju kanë
15 kërkuar që të dëshmoni përpara Dhomave të Specializuara në
16 çështjen gjyqësore, Prokurori i Specializuar kundër Salih
17 Mustafës për ta ndihmuar Trupin Gjykses që të marrë një
18 vendim. Pasi të keni bërë deklaratën solemne, do t'ju bëjnë
19 pyetje përfaqësuesit e Prokurorisë, pastaj përfaqësuesit që
20 përfaqësojnë viktimat e pranuar në proces dhe Avokati i
21 Mbrojtjes i Gjykatës dhe në fund ne, Gjykatësit, anëtarët e
22 Trupit Gjykses.

23 Dua që t'ju jap disa udhëzime sa u takon dhënies së
24 përgjigjeve për pyetjet që do t'ju bëjnë. Së pari, dëgjojini
25 me kujdes çdo pyetje. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 mund të kërkosësh që pyetjen të ta përsërisin. Duam që të na
2 thoni të vërtetën, të na tregoni se çfarë keni parë, se çfarë
3 keni ndier, se çfarë keni dëgjuar apo përjetuar vetë. Nëse nuk
4 e keni parë vetë apo nëse nuk e keni dëgjuar vetë, na thoni se
5 nga e keni marrë vesh një gjë. Mund të mos ju kujtohen të
6 gjitha hollësitë e ngjarjeve që kanë ndodhur, dhe nuk ka
7 problem për këtë. Ju lutem mos sajoni gjëra, mos i merrni me
8 mend, mjafton të thoni që, "Nuk e di". I kuptuat këto që sapo
9 ju thashë?

10 DËSHMITARI: Po, në rregull.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
12 shumë mirë. Tani kam disa këshilla praktike për ju sepse
13 ndodheni në një situatë të veçantë. Çdo gjë që ju do thoni
14 përkthehet dhe regjistrohet. Është e rëndësishme që të flisni
15 në mikrofon, afër mikrofonit. Të flisni qartë dhe ngadalë. Në
16 këtë mënyrë u jepni mundësi përkthyesve që ta bëjnë punën siç
17 duhet. Filloni të flisni vetëm pasi ta ketë mbaruar pyetjen
18 personi që po jua bën pyetjen. Mjafton të numëroni me vete
19 duke menduar deri në pesë, 1, 2, 3, 4, 5, sepse kjo u jep
20 mundësi përkthyesve që të përfundojnë njëherë përkthimin e
21 pyetjes të personit që sapo e ka bërë pyetjen. Prandaj dhe ne
22 të gjithë flasim disi më ngadalë këtu në Gjykatë.

23 Nëse keni pyetje, nëse keni nevojë për pauzë, nëse keni
24 nevojë për një ndihmë çfarëdo, mjafton të ngrini dorën edhe do
25 t'ju jap fjalën.

1 I kuptuat të gjitha këto?

2 DËSHMITARI: Po, faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E di
4 që po ju them shumë gjëra. Po është e rëndësishme t'i dini.
5 Mirë, faleminderit shumë.

6 Si me çdo dëshmitar, do të të lutem tani që të lexosh
7 deklaratën solemne. Të kujtoj se dhënia e një dëshmie të rreme
8 z. Dëshmitar përbën krim, pra vepër penale që bie në
9 kompetencën e Dhomave të Specializuara. Po këtë e kuptoni?

10 DËSHMITARI: Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
12 shoh që e keni përpara jush betimin solemn. Mjafton që të
13 lexoni teksti z. Dëshmitar.

14 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë dhe
15 përgjegjësinë time ligjore deklaroj solemnisht se do të them
16 të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk
17 do të mbaj të fshehta asgjë të cilën kam dijeni.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Dëshmitar, a mund të uleni pakëz më pranë mikrofonit që t'ju
20 dëgjojnë më mirë përkthyesit, t'jua dëgjojnë zërin më mirë
21 përkthyesit. Ose mbase mund ta afrojmë mikrofonin më afër në
22 drejtim të dëshmitarit.

23 [Gjykatësja u drejtohet përkthyesve] Nëse është e
24 mjaftueshme kjo gjë, përndryshe do të gjejmë një mënyrë
25 tjetër.

1 Tani mund të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit numër
2 W01679 duke filluar me bërjen e pyetjeve nga ZPS-ja.

3 Znj. Prokurore, ju keni vlerësuar se ju nevojiten shtatë
4 orë për t'i bërë pyetje këtij dëshmitari. Na informoni nëse ka
5 ndonjë ndryshim të këtij vlerësimi në funksion të
6 planifikimit.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës do ta
8 mbajmë në monitorim këtë bërje të pyetjeve.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit, keni fjalën.

11 Dëshmitari: W01679

12 Pyetje nga Z. D'Ascoli:

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëdita z. Dëshmitar. Unë jam
14 përfaqësuese e Prokurorisë. Do t'u bëj pyetjet juve sot. Gjatë
15 bërjes së pyetjeve, do t'u bëjmë pyetje lidhur me ngjarjet që
16 kanë ndodhur në vitin 1999.

17 Do t'ju tregoj dhe materiale pamore, përfshirë këtu foto
18 dhe vizatime. Znj. Kryetare e Trupit Gjykses ua ka shpjeguar
19 masat mbrojtëse që janë miratuar në rastin tuaj dhe përdorimin
20 e seancës private dhe publike. Unë do t'ju rikujtoj sa herë të
21 jetë e nevojshme, nëse jemi në seancë të hapur apo private, në
22 mënyrë që t'i kushtojmë vëmendje të veçantë kësaj gjëje, në
23 mënyrë që pyetjet dhe përgjigje të jenë të atilla që të
24 mbrojnë informacionin.

25 Të nderuar Gjykatës duke qenë se pyetjet e para kanë të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W01679 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Znj. D'Ascoli
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 12

1 bëjnë me të dhënat personale të dëshmitarit dhe informacione
2 të tjera identifikuese, i kërkoj Trupit Gjykses që të kalojmë
3 në seancë private për këtë pjesë të parë të pyetjeve.

4 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës
6 jemi në seancë private.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

8 Py. Z. Dëshmitar, në fillim, të dhënat personale.

9 Pë. Emrin e vërtetë?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
11 po. Jemi në seancë private tani.

12 Pë. Unë quhem [REDAKTUAR], i lindur në [REDAKTUAR].

13 Py. Po, ditëlindja, më falni, po vendlindja, vendi i lindjes?

14 Pë. Vendlindja [REDAKTUAR].

15 Py. Mirë, do t'ju bëj disa pyetje lidhur me pjesë e parë
16 të vitit 1999. Edhe njëherë mos harro, jemi në seancë private,
17 mos kij frikë të japësh informacione personale.

18 Zotëri ju lutem mendoni pakëz për muajt e parë të vitit
19 1999. Ku jetonit? Ku banonit atëherë?

20 Pë. Në atë kohë kam banu, kam jetu në Prishtinë. Po gjatë
21 luftës ne shkuam në një fshat.

22 Py. Po, do të arrijmë edhe tek kjo. A punonit asokohe kur
23 banonit në Prishtinë?

24 Pë. Po, po kemi punu.

25 Py. A mund të na thuash se çfarë bëje?

- 1 Pë. [REDAKTUAR]
- 2 Py. A merreshe me politikë? A ishe përfshirë në ndonjë grup
- 3 politik?
- 4 Pë. Jo, jo, njeri i thjesht.
- 5 Py. Po në pranverën e vitit 1999, ku ishe ti atëherë?
- 6 Pë. Pranvera 1999? Nuk më kujtohen kështu me pranverë e kështu
- 7 nuk më kujtohen, po nëse e ke fjalën gjatë luftës,po.
- 8 Py. Po, për luftën e kam fjalën.
- 9 Pë. Nëse e ke fjalën për luftën, atëherë mbasi i dëbun
- 10 njerëzit prej shtëpijave krejt, na vazhdaum e shkuam me u kyç
- 11 në ushtri.
- 12 Py. Në cilën ushtri u kyçe?
- 13 Pë. Në ushtri në UÇK.
- 14 Py. Përse deshe të kyçesh në UÇK?
- 15 Pë. Po deshta me kontribu për vendin tim, sikur shumica e
- 16 njerëzve.
- 17 Py. A të kujtohet nëse ka qenë përpara apo pas fillimit të
- 18 bombardimeve të NATO-s?
- 19 Pë. Kjo ka qenë pas bombardimeve. Që ajo kohë gjatë luftës u
- 20 konë, se njerëzit i dëbojshin për në Maqedoni, për të tjera
- 21 vende. Dikush ikte nëpër fshatra, që ajo kohë ka qenë.
- 22 Py. Në rregull.
- 23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës mund të
- 24 kalojmë përsëri në seancë të hapur tani.
- 25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W01679 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Znj. D'Ascoli
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 14

1 Sekretare, ju lutem na kaloni përsëri në seancë të hapur.

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës
4 jemi në seancë të hapur.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I
6 nderuar, më falni. Z. Dëshmitar, po kështu edhe për të
7 gjithë, ju them tani që jemi në seancë të hapur.

8 ZNJ. D'ASCOLI:

9 Py. Na thatë se shkuat të kyçeni në UÇK. Mund të na
10 thuash se ku shkuat?

11 Pë. Po, ne vazhdim rrugën për me shku me u kyç, vazhdim rrugën
12 me [REDAKTUAR] Vazhduam rrugën për [REDAKTUAR], nëpër male
13 ashtu vazhduam edhe dolëm në një fshat [REDAKTUAR].

14 Py. Çfarë gjetët në [REDAKTUAR]?

15 Pë. Në [REDAKTUAR] shkua me një [REDAKTUAR]. Aty kish pasë
16 njerëz, dhe aty qëndruam një natë, edhe i pyetëm njerëzit e
17 tjerë se ku është UÇK-ja se po duena me u kyç në luftë. Edhe
18 të nesërmen na tregun, edhe vazhdim për një fshat Zllash.

19 Py. Po çfarë bëre pastaj pasi shkuat në Zllash?

20 Pë. Mbasi shkum në Zllash, shkum te një [REDAKTUAR]. Aty u
21 lajmëruam. Aty kish pasë disa ushtarë, një komandant, një
22 epror, ku ta di unë. Që u konë disa djem, u lajmëruam aty, na
23 i morën shënimet krejt edhe okej mbetëm aty.

24 Py. A të kujtohen emrat? A të kujtohet emri i këtij
25 komandanti, epror?

1 Pë. Po, ky ka qenë Fatmir Sopi edhe tjetri Adem Shehu edhe një
2 Triumfi, ashtu i thojshin sa më kujtohet.

3 Py. Pra the që shkove tek ata, të morën ato të dhënat edhe
4 mbete aty, qëndrove aty? Çfarë bërë aty tek shkolla e
5 Zllashit.

6 Pë. Aty kemi qëndru e çdo ditë dalshim. Kemi pasë disa
7 stërvitje, disa ushtrime, ashtu kena bo me Adem Shehun e me
8 Triumfin. Edhe mbas 4-5 dite erdhën një njësi tjetër dhe u
9 morëm.

10 Py. Përpara se të arrijmë aty, the se gjete këta komandantët
11 në shkollën e Zllashit, a mund të -- a e di se cila njësi e
12 UÇK-së ndodhej në shkollën e Zllashit?

13 Pë. Sa e di unë, ajo u konë Brigada 153 ku jemi lajmëru na, ku
14 na kanë pranë, ku kemi qëndru q'ato ditë e ku kemi stërvitë.

15 Py. A mund të na përshkruani disa prej aktiviteteve të
16 trajnimit që keni bërë atje në ato ditë, në shkollën e
17 Zllashit?

18 Pë. Po ato stërvitje kanë qenë ma poshtë se shkolla, në një
19 farë pavijoni ka qenë, disa stërvitje kështu zvarrë, në tela,
20 me u ngjiturë nalt kështu, disa si lloj ushtrimesh të ushtrisë
21 diçka.

22 Py. A e njihnit Adem Shehun dhe Fatmir Sopin përpara se t'i
23 takonit ata në shkollë apo jo?

24 Pë. S'kam njoft kurrë kurrkund. Që ajo ka qenë njoftimi jem i
25 parë me ta që aty, me Fatmir Sopin, na ka marrë shënimet, e me

1 Adem Shehun na ka ndru që ato ditë, me dalë në stërvitje. Që
2 aty i kam njoft, që aty i kam pa, që aty, krejt, s'kom njoft
3 kurrkund.

4 Py. Si i mësuarat emrat e tyre? Nga e morët vesh si i kishin
5 emrat?

6 Pë. Po edhe aty, i ndëgjojshe edhe prej të tjerëve se ka pasë
7 shumë djem të rinj, që janë kyç aty edhe para neve kish pasë
8 njerëz. Edhe na tregojshin se kjo është Brigada 153 e Fatmir
9 Sopit, Adem Shehu është këtu, Triumfi për stërvitje, për këtu.
10 Kena dëgju edhe prej njerëzve aty krejt.

11 Py. A e mbani mend për afërsisht se me sa persona të tjerë jeni
12 stërvitur ju, mesatarisht?

13 Pë. Nuk e di saktë, po muj me thonë se në atë shkollë kanë
14 qenë shumë, ndoshta kanë qëndru deri në 40-50 vetë në atë
15 shkollë, kshu djem të rinj sikur na që u shkum me u kyç.

16 Py. Dhe për sa kohë qëndruat në shkollë?

17 Pë. Po, nuk më kujtohet saktë. Katër ditë, nëse s'gaboje të
18 pestën ditë, veç janë ardhë më kanë marrë një grup tjetër.

19 Py. Kush erdhi për t'ju marrë?

20 Pë. Po, unë nuk i kam njoftë. Erdhën katër ushtarë, ashtu me
21 tesha të zeza, ashtu, veç, Skifterat. Si kam kuptu masnej.
22 Skifterat u qujshin, si njilloj njësi speciale diçka.

23 Py. Pra, ju thatë që ishin katër ushtarë, të cilët ishin të
24 veshur me tesha të zeza, pra me uniforma të zeza. Dua t'ju
25 pyes, a ishin të armatosur këta persona?

- 1 Pë. Po, të armatosur.
- 2 Py. A kishin ndonjë shenjë dalluese në uniformat e tyre?
- 3 Pë. Po, kanë pasë disa emblema, masnej e kam kuptue ajo
- 4 lexojke BIA, BIA diçka, një farë, nja tre shkronja B-I-A.
- 5 Py. Pra, a patë ndonjë shkrim në këto emblemat apo në këto
- 6 pjesët dalluese që kishin personat?
- 7 Pë. Jo, krejt ça kam dallu, ajo BIA ka qenë.
- 8 Py. Në rregull. A mund të na thoni se çfarë ndodhi kur
- 9 mbërritën këta ushtarë?
- 10 Pë. Po, këta ushtarë, unë qeshë t'u nejt në oborr të shkollës
- 11 unë aty. Mu afrun, më vetën, thanë, "qysh e ke emrin?" I
- 12 tregova. Edhe tre nejtën me mu aty, një hyni mrena edhe mbasi
- 13 doli ai, thanë, "Hajde se kemi punë pak me ty. Po don
- 14 Komandanti diçka me bisedu me ty."
- 15 Py. Dhe çfarë bëre ti, në momentin kur ata të thanë që ti
- 16 duhet të shkoje me ta, çfarë bëre?
- 17 Pë. Nuk pata çfarë me bo. U nisa me ta, vazhdova me ta.
- 18 Py. A pate ndjesinë që mund të zgjidhje, të shkoje me ta ose
- 19 të mos shkoje?
- 20 Pë. Jo, unë nuk i kuptova, unë. Veç më thanë, "Ka me bisedu
- 21 komandanti" edhe u nisa me ta. Unë s'kam mendu kurrigjo. Edhe
- 22 s'ke pasë ça me mendu, ti, katër vetë të armatosur, ti edhe me
- 23 të shku menja me mendu diçka s'ke mujt.
- 24 Py. A të treguan ndonjë dokument ata ty për të justifikuar
- 25 faktin që ju kërkuan të shkonit diku tjetër me ta?

1 Pë. Jo, jo, kurrfarë dokumenti s'më tregun, as kurrigjo. Veç më
2 thanë, "Duhet me ardhë me neve. Ka me të pyet komandanti
3 diçka." Edhe që kaq, ma shumë s'më kanë thënë kurrigjo.

4 Py. A u prezantuan? A thanë kush ishin me emër ose me nofkë?

5 Pë. Jo, jo, veç kanë thonë, "Ne jemi si njësi speciale,
6 Skifterat" që ashtu më kanë thonë veç "Duhet me vazhdu me
7 ardhë me neve," kurrigja ma shumë.

8 Py. A të treguan, të thanë ty ata se ku do të çonin?

9 Pë. Duhesh me ardhë në shtab te na, në një shtab tjetër, te
10 na, te komandanti.

11 Py. Mirë në rregull. Na trego pak ju lutem se çfarë ndodhi. Ku
12 të dërguan edhe si shkuat atje?

13 Pë. Na vazhdum që atë rrugë, një farë pjese, një farë cope,
14 vazhdum që ashtu në komë me ec. Edhe shkum në një vend si, nuk
15 e di as vetë se hera e parë në jetën tem që qeshë në arë vend.
16 Kur u afrum nga dikund, ata thanë, "ungje, ule krytë," edhe më
17 nuk dijsa as ku po më çojnë as ça po bohet. Kur jena afru
18 krejt afër, afër do objekteve dikund, ka qenë një thes i zi,
19 nëse s'gaboj, ma vunë në krye e më çun në një objekt dikund
20 mrena më shtinën.

21 Py. Çfarë ndodhi në momentin kur të çun brenda kësaj ndërtese?

22 Pë. Kur më çun brenda në ndërtese, aty kish konë [REDAKTUAR] i
23 tynve, edhe ish konë ul, kështu përballë, edhe më tha, "Kush
24 je?" I tregova. Tha, "Për çfarë ke ardhë ktu?"

25 Tregova, i thashë jam ardh me u kyç në ushtri, me kontribu

1 nonji send. Tha, "pse po rren?". Që ksi sendesh, me të shtyrë,
2 me ngrit zonin, me ato sendet e veta, me ato ku ta di unë, me
3 ato bërtitmat e mëdhaja ia nisi. U çu edhe ma mëshoi edhe
4 fillun me më rreh krejt.

5 Py. Në rregull, le ta marrim hap pas hapi. Ju thatë që ju çuan
6 brenda ndërtesës, që kishte një [REDAKTUAR] atje, që ky
7 [REDAKTUAR] ju pyeti ju. Po këta ushtarët e tjerë, a vazhduan
8 të qëndronin në të njëjtën dhomë me ju?

9 Pë. Vetëm unë.

10 Py. [REDAKTUAR] a u prezantua se kush ishte? A e kuptuat ju se
11 si quhej [REDAKTUAR]?

12 Pë. Jo, atë se kam kuptu menjëherë, nuk e kam kuptu. Po masnej
13 e kam kuptu kush është, dhe tue dëgjju [REDAKTUAR].

14 Py. A dëgjuat ushtarë të tjerë që i drejtoheshin [REDAKTUAR]
15 në ndonjë lloj mënyre?

16 Pë. Jo, veç që me atë fjalë, "[REDAKTUAR], qe, e prunëm kyt
17 djalin". Në fillim kur më kanë çu, tha, "[REDAKTUAR], qe, e
18 prunëm kyt djalin". Edhe e kam parë që ai asht [REDAKTUAR]. Se
19 të tjerët nuk asht se u drejtojshin tek ai krejt.

20 Py. Çfarë do të thuash kur thua që unë më vonë e kam mësuar që
21 ai ishte [REDAKTUAR]?

22 Pë. Jo, ai [REDAKTUAR] e dita që shkova para një [REDAKTUAR],
23 unë e dita se më kanë çu, po d.m.th. emër ose diçka të tija
24 nuk dita për momentin, as u prezantu, as kurrigjo, nuk kam ditë
25 kurrigjo, veç kur më çun para atijna.

- 1 Py. Pasi u dërguat brenda kësaj dhome, a mundët që të shihnit?
- 2 Sytë i kishe të mbuluar apo jo?
- 3 Pë. Ma kanë hjekë atë, ma hjekën thesin. Normal që kështu
- 4 sikur me shiqu që'ktu.
- 5 Py. Në rregull. A të kujtohet se çfarë kishte veshur
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 Pë. Vesh një jakne kështu të ushtrisë si me lara kështu.
- 8 Py. Po ndonjë gjë tjetër? A kishte ndonjë shenjë, a ka ndonjë
- 9 detaj tjetër që mbani mend nga mënyra se si ishte veshur ai?
- 10 Pë. Jo, s'më kujtohet. S'mbaj mend.
- 11 Py. Pra, ti na the që ai ju pyeti ju. Çfarë ju tha
- 12 specifikisht? Çfarë pyetjesh ju bëri specifikisht? Dhe çfarë
- 13 përgjigjesh dhatë ju?
- 14 Pë. Po ai më pyeti, më tha, "Për çfarë ke ardhë ti këtu?" Unë
- 15 i tregova, i thashë, "Kam ardhë me u kyç në ushtri, me
- 16 kontribu ndonji send, sikur shumë të tjerë." Ai tha, "Po rren,
- 17 se ke ardhë për qëllime të tjera."
- 18 Py. A ju shpjegoi ai ju arsyen sepse ju kishin çuar në atë
- 19 vend?
- 20 Pë. Jo, s'më shpjegoi kurrëgj, absolut, hiç.
- 21 Py. A ju tha juve ky person që ju ishit nën arrest?
- 22 Pë. Jo, jo nuk më tha as nën arrest, as kurrëgj, veç çka me
- 23 vetun "Për çka je ardhë këtu?"
- 24 Py. A ju tregoi ndonjë urdhër, ndonjë fletë
- 25 arresti?

1 Pë. Jo, jo kurrgjo.

2 Py. Dhe a mund të mendoni për ndonjë arsye sepse [REDAKTUAR]

3 të tha ty që ti po gënjeje?

4 Pë. Jo, nuk e di. Nuk e di. Ata i kanë pasë ato metodat e

5 veta, ato procedurat e veta, ça di unë. Nuk di.

6 Py. Çfarë bëri [REDAKTUAR] ndërkohë që po të merrte në pyetje

7 ty?

8 Pë. Ai filloi ashtu me disa bërtitma, disa "Pse po rren? Trego

9 çka ke ardhë?" Kësi sende, edhe shajke. Edhe u çu më sulmoi.

10 Ia nisi me më rreh. Edhe fillun këta të tjerët anej.

11 Py. Mund të na thuash se si ju rrahu?

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 Py. A dëgjuat ndonjë person që i jepte urdhra të tjerëve që të

19 rrihnin ty?

20 Pë. Kam dëgju veç kur ka fillu ky, kur më ka mëshu shuplakën,

21 tha, "Myteni krejt".

22 Py. Dhe pasi e dëgjuat këtë urdhër të [REDAKTUAR], pra këtë

23 çfarë tha komandanti, të tjerët e respektuan këtë rregull të

24 tij, d.m.th. këtë çfarë tha komandanti? A e vunë në jetë të

25 tjerët?

1 Pë. Po, po, e respektun derisa më alivanosën përtokë e mirë.

2 Py. A mund të na thuash se si përfundoi e rrahura?

3 Pë. E rrahura përfundoi deri në alivanosje. Më kapën në zhag,
4 edhe më qitën se mu më gjakosën krejt.

5 Py. Ku të tërhoqën zvarrë?

6 Pë. Më tërhoqën prej q'asaj dhomës që aty, më qitën jashtë, më
7 çun në një ahër, në një stallë të lopëve.

8 Py. Në rregull. Përpara sesa të kalojmë te ahri, do desha të
9 qartësoja disa aspekte të dëshmisë që keni dhënë deri tani.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen e
11 Trupit Gjykues, në përputhje me Rregullën 143(1), dua që t'i
12 tregoj disa transkripte dëshmitarit thjesht për t'i freskuar
13 kujdesën e tij.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull, mund të vijoni znj. Prokurore.

16 ZNJ. D'ASCOLI:

17 Py. Zotëri, a mbani mend që të keni dhënë një dëshmi për Zyrën
18 e Prokurorisë së Specializuar në vitin [REDAKTUAR]?

19 Pë. Po.

20 Py. Në fakt ju jeni intervistuar nga një Prokuror i ZPS-së më
21 datën [REDAKTUAR]. A e mbani mend këtë datë?

22 Pë. Datën nuk e mbaj mend. E di që jam intervistuar prej një

23 Prokurori. Edhe ka pasë aty disa, prej një deklaratës të

24 vjetër, ka pasë disa, që s'kena mujt me u kuptu. Po jom

25 intervistuar prej një prokurori të juaj, po.

1 Py. Në rregull, do t'i kthehemi këtij aspekti pak më vonë. A e
2 keni dhënë atë deklaratë lirshëm dhe në mënyrë vullnetare?

3 Pë. Po.

4 Py. A jeni kërcënuar a jeni detyruar në ndonjë lloj mënyre për
5 ta dhënë atë deklaratë?

6 Pë. Jo, jo, jo. Ajo ka qenë edhe dëshirë. Gjithçka në rregull
7 u konë.

8 Py. A i jeni përgjigjur pyetjeve të bëra nga prokurori me
9 njohuritë dhe dijenitë tuaja më të mira?

10 Pë. Aq sa më ka mbetë në kry, sa kam mujt me mbajt mend.

11 S'kena mujt me u kuptu mirë me to, përmes që asaj deklaratës
12 vjetër, s'kena mujt me u kuptu mirë me to, po aq sa kam mbajt
13 mend edhe sa kam që i mbaj mend, jam mundu me ja tregu.

14 ZNJ. D'ASCOLI: Të nderuar Gjykatës, Dëshmitari po i
15 referohet deklaratës së vjetër të dhënë për UNMIK-un dhe do
16 t'i kthehemi kësaj deklarate më vonë n.q.s. do të jetë e
17 nevojshme.

18 Py. Atëherë zotëri, a kanë qenë të vërteta përgjigjet që i
19 keni dhënë pyetjeve të ZPS-së në atë kohë?

20 Pë. Të vërteta aq sa mbaj mend të vërteta janë.

21 ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] A mund t'ju kërkoj znj.

22 Sekretare që të shfaqni transkriptin me shenjën ERN 060698-TR-ET,
23 e rishikuar Pjesa 3, që është në Nënndarjen 3, në listën e
24 provave materiale për këtë dëshmitar. Dua ju lutem që të
25 shfaqni rreshtin 13, në faqen 11, dhe sërish në faqen 11, dua

1 që të shikojmë rreshtin 9, që është transkripti përkërkues në
2 gjuhën shqipe.

3 Zotëri, tani, shkurtimisht do të shikoni dy transkripte
4 që do të shfaqen në ekranin tuaj. Ju lutem shihni n.q.s. mund
5 të shihni transkriptin në gjuhën shqipe.

6 Py. Z. Dëshmitar, unë do të lexoj një pjesë të pyetjeve dhe
7 të përgjigjeve që janë shkëmbyer gjatë intervistës që keni
8 pasur ju me ZPS-në me datën [REDAKTUAR]. Ose mund të
9 ndiqni tekstin e shkruar në gjuhën shqipe në ekranin tuaj, ose
10 mund të dëgjoni në interpretimin, në përkthimin në shqip
11 përmes kufjeve.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të
13 filloj leximin nga rreshti 13, që përkon me rreshtin 9 të
14 versionit në gjuhën shqipe, pra transkriptit në gjuhën shqipe.
15 Py. Tani po lexoj. "Në rregull. A të thanë ty ata se për
16 çfarë bëhej fjalë?" dhe këtu Prokurori pra po ju bën juve një
17 pyetje. Ndërkohë, përgjigjja juaj është kjo:

18 "Jo, ata veç më thanë që [REDAKTUAR] ka diçka për të të
19 pyetur. Pra ai do t'ju pyes për diçka."

20 Tani vijojmë me pyetjen e Prokurorit. "A ju kanë
21 maltrajtuar, a ju kanë keqtrajtuar juve ndërkohë që ju kanë
22 dërguar në ndërtesën tjetër?"

23 Përgjigjja juaj është, "Jo, jo."

24 "Py. Në rregull. Pra kur ti mbërrite tek kjo ndërtesa,
25 çfarë të ndodhi më pas?"

1 Përgjigjja që ti ke dhënë është kjo: "Më shtinë brenda,
2 kishte do shkallë. Unë shkova në katin e dytë të asaj ndërtese
3 dhe hyra brenda një dhome. Atje ishte një person, [REDAKTUAR]
4 i ashtuquajtur i këtyre, dhe ai tha, "Unë jam [REDAKTUAR].".

5 Edhe pyetja pastaj është, "A mund të ta gërmëzoni këtë?"
6 Edhe ti i thua, [REDAKTUAR]

7 Z. Dëshmitar, a e mbani mend këtë pjesë të dëshmisë tuaj?
8 Pë. Po tash kur po e shoh po e mbaj mend, se nuk e di. Këtu ka
9 qenë që s'kena mujt me u kuptu edhe mirë me ato, shkak i asaj
10 të vjetrës.

11 Py. Ju lutem a mund të na e sqaroni pak atë që sapo thatë?

12 Pë. Thashë se tash kur po e shoh po më kujtohet, po është puna
13 që s'kom mujt edhe mirë, edhe sherri i deklaratës së vjetër.

14 Disa pyetje që mi bënte Prokurori, s'kom mujt me u kuptu mirë
15 me të. Kam pasë problem me u kuptu me disa gjona. Edhe kjo
16 është e vërtetë çka shkruhet këtu se më kanë çu tek ky
17 [REDAKTUAR] dhe kjo ka ndodhë.

18 Py. Siç e thashë dhe më përpara, ne do të kalojmë në një pjesë
19 më të më vonë të ditës së sotme, te qartësimi që ka të bëjë me
20 deklaratën që ju keni dhënë UNMIK-ut. Tani le të sqarojmë këtë
21 pjesë? A e mbani mend ju që në momentin kur u dërguat në këtë
22 ndërtesë, në këtë dhomë, [REDAKTUAR] u prezantua se ishte
23 [REDAKTUAR]?

24 Pë. Po unë aty e kam ditë që është ky [REDAKTUAR]. Edhe i kom
25 ndie këta kolegët e tij, t'u e thirrë [REDAKTUAR]. Aty i kam

1 ditë që është ky [REDAKTUAR].

2 Py.[Përkthim] Në rregull. Përderisa jemi te kjo pikë, dua
3 që të sqarojmë këtë pjesë të deklaratës tuaj.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që
5 do të ishte më mirë që të kalonim në seancë private.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
7 rregull znj. Prokurore.

8 Znj. Sekretare a mund të kalojmë ju lutem në seancë
9 private?

10 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
12 jemi në seancë private.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit znj. Sekretare.

15 E nderuar Prokurore, ju lutem vijoni.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar
17 Gjykatës.

18 Z. Dëshmitar, do kalojmë tek deklaratata e mëparshme që i
19 keni dhënë UNMIK-ut. Dhe sa për kujtesë dua të theksoj dhe
20 njëherë që tani jemi në sesion privat.

21 A mund t'i kërkoj Sekretares që të na shfaqë dokumentin
22 që është shënuar me numrin e identifikimit ERN-7000687 deri në
23 7000691, RED 1, versioni në anglisht, faqja 1; ndërkohë, që
24 versioni në shqip është faqja 4. Është i njëjti dokument,
25 ndërkohë që për sqarime të mëtejshme, ky është një dokument që

1 përfshihet në Ndarjen 1 të listës së dokumenteve për
2 dëshmitarin.
3 Py. Z. Dëshmitar, pra, ju do të shihni në ekranin tuaj
4 deklaratën e mëparshme që i keni dhënë hetuesve të UNMIK-ut.
5 Dhe sërish do të keni versionin në anglisht dhe versionin në
6 gjuhën shqipe. Ose mund të lexoni shqipen në ekran ose mund të
7 dëgjoni përkthimin të fjalive në anglisht që do të bëhen
8 përmes përkthyesve, përmes kufjeve.

9 Unë do lexoj nga mesi i faqes 1 të versionit në anglisht.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk e shoh të jetë e dukshme.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
12 kam diçka në ekran. Nuk e di n.q.s. edhe juve keni diçka në
13 ekran.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, e kam deklaratën, por
15 gjysma është bosh. Tani e shoh versionin në anglisht të kësaj
16 deklarate - atë pjesë që më duhet.

17 Py. Kam përshtypjen që bëhet fjalë për rreshtin e pestë nga
18 fundi i ekranit.

19 Z. Dëshmitar, ju në këtë deklaratë thoni që:

20 "Unë më pas u dërgova në katin e dytë. Atje më thanë që
21 isha hajdut, isha spiun. Dhe unë i thashë që jo nuk isha.

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR] Ishte [REDAKTUAR] i
24 cili më tha mua që unë isha spiun, dhe që filloi të më rrihte,
25 të më gjuante me shqelma, me shuplaka dhe të urdhëronte të

1 tjerët që të më gjuanin me [REDAKTUAR]."

2 Pë. Po, edhe unë jam konë mundu me thonë që këto, po s'di sa

3 po mund me u kuptu. Po aty ka pasë disa sende të pakjarta me

4 Prokurorin e juaj, se unë nuk e kom shkru këtë deklaratë. Unë e

5 kam thonë kështu. Këtu shkruhet tjetër, ka vende-vende që

6 shkruhet tjetër send. Edhe s'kom mujt me u kuptu me Prokurorin

7 e juaj në bazë të disa thashethemeve që këtu, se këtë

8 deklaratë e ka shkru, nëse s'gaboj një përkthyes. Ajo

9 shkrimin, as shkrimin se kuptoj këtë shkrim.

10 Py. Po e kuptojmë këtë Z. Dëshmitar. Lidhur me pjesën e

11 deklaratës që unë sapo lexova. A ishte e saktë kjo pjesë që

12 lexova apo keni për të bërë ndonjë korrigjim lidhur me këtë

13 pjesë, pjesën që sapo e lexova përpara pak minutash?

14 Pë. Jo, nuk kam me bo korrigjim. Q'ato që i mbaj mend është që

15 kjo pjesë. Kjo nuk mundet me ndryshu. Kurse është q'ajo pjesë

16 qysh po mund unë me tregu, që këto.

17 Py. Po, e kuptoj, pjesët që lexova unë, është pjesa që flet,

18 atëherë kur të çuan në katin e dytë, ku ishte [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR] dhe filloi të rrehte. Kjo pjesë që të çuan në kat

20 të dytë dhe ai filloi të rrehte, të të quante spiun, a është e

21 saktë, apo do të bësh ndonjë korrigjim tek kjo?

22 Pë. Jo, jo s'kam çfarë bëj korrigjim. Kjo është e saktë. Që

23 këto po mundojna me tregu, me përmbledh që këto po mundojna.

24 Edhe pse tash kanë kalu shumë vite kanë kalu edhe këto du me

25 tregue për afërsisht. Që këtë histori po du me tregu.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W01679 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Znj. D'Ascoli
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 29

1 Py. Sigurisht z. Dëshmitar. Prandaj dhe duam që t'i kemi të
2 qarta gjërat edhe që ti je në rregull me këto sqarimet e bëra.
3 Pra është e qartë tani. Të të bëj një pyetje. Ti the që është
4 e shkruar me shkrim dore kjo deklaratë. Dhe unë vura re këtu
5 është shkruajtur [REDAKTUAR]. Ke dashë me thënë [REDAKTUAR]
6 hetuesit të UNMIK-ut?

7 Pë. Kam dashë me thonë [REDAKTUAR] nuk, nuk ka. Po siç
8 tregova unë nuk e kom shkru këtë. E ka shkru një përkthyes.
9 Unë jam mundu me tregu kështu, ajo ka shkru.

10 Py. Është e qartë. E di se ka dhe pjesë të tjera të kësaj
11 deklarate të UNMIK-ut, të cilat ti dëshiron që ti korrigjosh.
12 Por të kalojmë tek një pjesë e dëshmisë pastaj më vonë do ta
13 bëjmë këtë.

14 Pë. Deshta pak me konë më i qartë, me i sqaru se kom pa, me
15 Prokurorin e ju j kom pa disa, s'kena mujt me u kuptu në disa
16 pyetje, e ça ka shkru këtu. Veç deshta pak me ditë me ta sqaru
17 pak që këtë send.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Dëshmitar, ju falënderojmë shumë që dëshironi të sqaroni disa
20 gjëra të caktuara sepse për këtë është edhe dëshmia juaj që
21 jepni këtu në sallë. Dhe siç e kuptova dhe nga zonja
22 Prokurore, është kjo mundësia që ju të thoni egzaktesisht, pra
23 me saktësi atë që doni të thoni. Pra do vijë edhe ajo mundësi
24 që ta sqaroni.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit e nderuara

1 Gjykatëse. Unë mendoj se mund të rikthehem në seancë të
2 hapur.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
4 Sekretare, a mund të na rikaloni në seancë të hapur ju lutem?
5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi rikthyer në seancë
7 publike.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit znj. Sekretare.

10 Znj. Prokurore, vijoni.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar
12 Gjykatës.

13 Py. Z. Dëshmitar, na thatë pak më parë në faqen 23 të
14 transkriptit, të seancës sot, na thatë që, dëgjova që kolegët
15 e tij e thërrisnin [REDAKTUAR]. A mund të na thuash kur ka
ndodhur
16 kjo gjatë të rrahurës, të cilën e përshkruat pak më parë?

17 Pë. Po kjo ka ndodhë që aty për që aty, për momentin, që
18 kanë fillu me të rreh aty, ke ndi "Çfarë me bo [REDAKTUAR]?"
19 kur e kanë vet, thonë "Mbyte krejt". Sa më kujtohet mu, sa më
20 ka mbetë në krye ajo.

21 Py. Mirë. Edhe thatë se e rrahura mori fund kur të larguan, të
22 çuan diku në një stallë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
24 Prokurore, më falni që ju ndërpres. Por unë shikoj që në
25 ekranin tim, transkripti nuk ka më tekst tjetër. Dhe unë po

1 shoh edhe në anën e djathtë edhe një prej kolegëve bie dakord
2 me mua. Në fakt kjo është një vërejtje që s'ka të bëjë me ju
3 aq shumë sa çka të bëjë me ekipin teknik për të parë pse na ka
4 ngecur dhe nuk po lëviz në ekran transkripti i seancës.

5 [Trupi Gjykues dhe Sekretarja këshillohen]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
7 informuan që Drejtoria Informatike po e sheh këtë çështje dhe
8 do presim.

9 Z. Dëshmitar, kemi një problem tani me procesverbalin,
10 tekstin e zbardhur në transkript siç e quajmë ne, të gjërave
11 që thuhet në Gjykatë, të cilat menjëherë shkruhen në ekran, po
12 nuk po na shfaqet më në ekran. Kështu që do shikojmë se cili
13 është problemi teknik. Do presim paksa.

14 [Trupi Gjykues këshillohet]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Dëshmitar, mesa duket kemi një problem teknik, çka do të thotë
17 se tani për tani do ta bëjmë pauzën pak më herët nga çë kishim
18 parashikuar. E kishim parashikuar që në orën 11.00 ta bënim
19 pauzën, po do ta bëjmë tani.

20 Ah qenka, është rregulluar. Po, po e shoh. E kemi përpara
21 ekranit. Funkcionon, është në rregull, por në ekran nuk më del
22 gjë.

23 Në ekranin tim nuk më del. As ju?

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ne e kemi në ekran.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Epo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 prapë është problem se do të thotë që jo të gjithë jemi të
2 lidhur. Tani që flas ju po shkruani. Ju shoh, po mua nuk më
3 del gjë.

4 Avokati i Mbrojtjes, po në ekranin tuaj?

5 Z. VON BONE: [Përkthim] As unë ekranin tim nuk e shoh, e
6 nderuar Gjykatëse. Aty në ekranin tjetër duket që del, po jo
7 këtu.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
9 shohim. Unë mendoj se problemi është ke ky ekran, sepse e
10 shikoj në Sistemin Legal.

11 Z. von Bone?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Diçka del, por, jo është katër
13 minuta më mbrapa pak a shumë të themi.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Epo
15 atëherë nuk më duket se mund të vazhdojmë kështu.

16 Atëherë, z. Dëshmitar, do ta bëjmë pauzën tani, pauzën
17 prej gjysmë ore, çka do të thotë se do bëjmë pauzë deri në
18 orën 11 e një çerek. Shoqëruesja e sallës do t'ju shoqërojë
19 për të dalë jashtë nga salla. Do të rishihemi pas gjysmë ore.

20 DËSHMITARI: Faleminderit.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Atëherë do bëjmë një pushim prej gjysmë ore. Do të rishihemi
24 pastaj orës 11 e një çerek. Shpresojmë deri atëherë të jetë
25 rregulluar gjithçka.

26 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 --- Pauza fillon në orën 10.44 paradite

2 --- Seanca rifillon në orën 11.15 paradite

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni
4 ju lutem. Të verifikojmë nëse funksionon. Dhe shoh që në ekran
5 teksti shfaqet. Pra do të thotë se është në rregull.

6 Shoh që të gjithë tundin kokën në shenjë konfirmimi. Po
7 identifikoheni dhe po funksionon apo thjesht po pohoni se po
8 identifikoheni për të hyrë në sistem?

9 Avokat i Mbrojtjes, nga ana jua çdo gjë është në
10 rregull?

11 Prokuroria?

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, e nderuara Gjykatëse
13 gjithçka funksionon në rregull.

14 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja këshillohen]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
16 kërkuar që të vijë një teknik në sallë për të parë se çfarë
17 mund të bëjmë. Sepse për të gjithë funksionon, vetëm për një.
18 Po, Mbrojtësja e Viktimave ju lutem.

19 ZNJ. PUES: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, unë sugjeroj,
20 meqenëse transkripti im është në rregull, mendoj se duhet të
21 vazhdojmë me dhënien e dëshmisë. Të improvizojmë dhe të shohim
22 sesi mund të rregullohet. Se është e çuditshme që njëri
23 kompjuter funksionon, tjetri jo. Po besoj se mund të
24 rregullohet me kalimin e kohës.

25 Që kështu ne nuk kemi kundërshtim nga ana jonë që të

1 vijojmë me dëshminë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

3 Mbrojtëse e Viktimave, faleminderit shumë për këtë sugjerim.

4 Do të vijë dikush që të shikojë kompjuterin e

5 bashkëmbrojtëses, koleges tuaj. Kështu që është mirë të

6 vazhdojmë, që të mos presim. Faleminderit për këtë.

7 [Dëshmitari fillon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Atëherë do ta përsëris edhe njëherë atë që thashë, për

10 procesverbalin. Nuk shoh asnjë ndryshim në përbërjen e ekipeve

11 të ndryshme.

12 Z. Dëshmitar, mirë se erdhët përsëri. Do të vazhdojmë

13 pyetjet që jua bën përfaqësuesja e Zyrës së Prokurorit të

14 Specializuar. Shpresoj se nuk do të kemi më probleme teknike.

15 Znj. Prokurore, keni fjalën.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit e nderuara

17 Gjykatëse.

18 Py. Z. Dëshmitar, do t'u kthehem disa prej pyetjeve të cilat

19 po i diskutonim bashkë përpara pushimit. Pak më parë thatë se

20 dëgjuat të tjerët, pra ushtarët e tjerë e thërrisnin

21 [REDAKTUAR]. Është në faqe 23, rreshti 8, i transkriptit

22 sot, të seancës sot.

23 Përpara pushimit në intervistën që i keni dhënë ZPS-së,

24 të cilën jua lexova, ju thatë që, [REDAKTUAR] u prezantua vetë

25 me emrin [REDAKTUAR]. Të kujtohet?

1 Pë. Po, këtë ndoshta e kam thënë, por për momentin s'mu kujtu.

2 Po edhe ndërkohë ça janë konë t'u më torturu këta, e kanë

3 thirrë, kur e kanë vet "Ça me bo [REDAKTUAR] Ky ka thonë,
"Mbyteni

4 krejt." Edhe unë, që aty e kom kuptu. Që aty është prezantu,

5 po unë se kam kuptu për ça e pate fjalën, bash saktë?

6 Py. Në rregull. Z. Dëshmitar, si mori fund e rrahura? Si

7 përfundoi e rrahura?

8 Pë. E rrahura përfundoi me lloj alivanosje q'ashtu. Me kapën

9 prej krahu e më ngrehshin zhag q'ashtu. Më qitën prej atij

10 objekti, prej të nalti më qitën jashtë.

11 Py. Ku të çuan pastaj?

12 Pë. Më çun që n'atë objekt, më çun poshtë, në një ahër, një

13 stallë.

14 Py. A na e përshkruan dot këtë vend, këtë ahur mbasi të

15 rrahën? Përafërsisht, për aq sa të kujtohet.

16 Pë. Për aq sa më kujtohet, aty vend, tullë, gurë, sende. Ky

17 objekti si me gurë, druna, një derë e drunit, si lagështi ka

18 pasë, si kashtë, si kështu.

19 Py. Brenda kësaj stallës së kafshëve a kishte dikush tjetër z.

20 Dëshmitar? Vetëm përgjigjuni me po ose me jo meqenëse jemi në

21 seancë të hapur. Më pas do t'i kthehem në seancë private nëse

22 do të jetë nevoja.

23 Pra po e përsëris pyetjen edhe njëherë. A kishte ndonjë

24 person tjetër brenda kësaj stallës së lopëve. Mjafton të thoni

25 po ose jo.

- 1 Pë. Kishte, po.
- 2 Py. Mirë. A e përshkruani dot se çfarë ndodhi kur ishit në atë
3 ahur, sa kohë të mbajtën aty, çfarë ndodhi në ditët e
4 mëpasshme? Çfarëdo që të kujtohet.
- 5 Pë. Po më kujtohet aty, kam ndejt 17 netë d.m.th. në të 18-n
6 ditë jam liru prej atij vendi. Aty ka ndodhë çdo ditë tortura,
7 lloj lloj torturash. Që aty kemi ndejt që aty edhe veç ke nejt
8 ke pritun kush po vjen me të rreh ose me të marrë me të çu
9 nalt me të rreh ose ksi sendesh, aq sa më kujtohet.
- 10 Py. A e përshkruani dot çfarë lloj rrahje apo maltrajtimi ke
11 pësuar ato ditë në ahër qoftë lart, në katin lart, apo qoftë
12 në katin poshtë, në të dyja vendndodhjet e përmendura?
- 13 Pë. Po, na kanë rreh për shembull shkelma, boksa, stupca,
14 shufra ka pasë diçka të hekrit. Na kanë djeg me qiri kështu,
15 ta mbajshin qirin në shpinë, të djegshin, lloj-lloj torturash,
16 me rrymë. Kanë pasë një farë si kuti me rrymë që të lidhshin
17 në komë. Ka pasë lloj-lloj torturash.
- 18 Py. Z. Dëshmitar, e di se është e vështirë. Po jam e detyruar
19 që t'u kthehem këtyre gjërave dhe të kërkoj më shumë hollësi
20 lidhur me secilin maltrajtim që përmende. A mund të
21 përshkruash se si të rrahën? Përmende shkelma, bokse, stupca.
22 A mund ta përshkruash mënyrën se si të kanë rrahur?
- 23 Pë. Po në mënyrën si të kanë rrahë aty - kur të çojshin nalt
24 ata, marrshin, i kanë pasë do bishta të sakicave kështu ne ju
25 thojmë, edhe kanë pasë edhe shufra për shembull sikur të

1 policisë. Këto shufra janë konë të hekrit. Me ato ma shumë të
2 goditshin.

3 Py. Përmende edhe qirinj. A mund të përshkruash se çfarë ju
4 bënë me qirinj?

5 Pë. Po të marrshin të ulshin në karrige edhe i vejshin qirat
6 edhe ta majshin afër shpinës, edhe ajo e qiriut të pikëke të
7 djegke, me të djeg.

8 Py. Kjo poshtë apo lart? Në katin lart apo në katin poshtë?

9 Pë. Këto i kanë bo lart.

10 Py. Përmende edhe një kuti të rrymës. A mund ta shpjegosh sesi
11 është bërë maltrajtimi me rrymë?

12 Pë. Po ka qenë si kuti, t'i lidhshin telat në komë, në të dy
13 këmbët. Edhe ku ta di unë e lëshojshin atje. Ajo të jepte
14 dridhje, kështu. T'i lidhshin telat t'i lidhshin në të dy
15 këmbët, telat t'i lidhshin edhe e lëshojshin, ku ta di unë.

16 Py. A ju kujtohen keqtrajttime, maltrajttime të tjera, për
17 shembull a ju kujtohen veçanërisht trajttime degraduese apo
18 përulëse që keni marrë?

19 Pë. Nuk po kuptoj që këto znj. Prokurore.

20 Py. A jeni abuzuar seksualisht në ndonjë mënyrë?

21 Pë. Jo, seksualisht, jo, por m'kanë urinu.

22 Py. Dhe si e kanë bërë këtë gjë? A na e përshkruan dot të
23 lutem?

24 Pë. Po kjo ka ndodhë, një herë ka ndodhë poshtë. Se jam kenë
25 në bodrum, unë lypa do ujë me na i pru. Edhe erdhën nja dy

1 ushtarë të tijna edhe më rrehën edhe më shtrinë përtokë edhe
2 më urinun thanë, "Qe uji."

3 Py. A ka ndodhur vetëm një herë kjo gjë apo ka ndodhur disa
4 herë? Sa herë ka ndodhur kjo gjë?

5 Pë. Me sa më kujtohet mu ka ndodhë nja dy herë, sa e mbaj mend
6 atë. Ka ndodhë nja dy herë.

7 Py. Dhe a keni parë ju, me sytë tuaj, ndonjë person tjetër
8 ndaj të cilit është urinuar? Dhe sërish në këtë fazë ju lutem
9 na jepni një përgjigje vetëm me po ose jo. Dhe n.q.s. do jetë
10 e nevojshme, pastaj do të kalojmë në detaje kur të jemi në
11 seancë private.

12 Pë. Nuk më kujtohet për momentin. Nuk kisha me thonë se kam pa
13 dikënd, po mu më ka ndodhë.

14 Py. Në rregull, e kuptoj. Gjatë kohës kur ju ishit i ndaluar
15 aty në stallë, sa herë ju kanë rrahur? Sa shpesh ka ndodhur që
16 ju kanë rrahur?

17 Pë. Po, kjo pothuajse çdo ditë, e kom pasë që atë. Ndoshta ka
18 ndodhë ndonjë ditë që s'më kanë rreh kështu shumë. Ka ndodhë
19 me pshtu me më pak. Pothuajse gati çdo ditë e kom pasë.

20 Py. Dhe përderisa juve përmendët si stallën edhe pjesën në
21 dhomën sipër, çfarë ju bënë juve në stallë? Çfarë lloj
22 keqtrajtimesh keni pësuar juve ndërkohë që mbaheshit në
23 stallë?

24 Pë. Po ka ndodhë që kështu, kush ka ardhë, kush e ka çel
25 derën, pata hy në ndonji shkelm ose ndonji boks ose ndonji

1 diçka, nuk ke pështu.

2 Py. Edhe kjo ju ka ndodhur edhe juve edhe personave të tjerë
3 të cilët mbaheshin aty në të njëjtin vend, në stallë?

4 Pë. Po, po, kjo ka ndodhë edhe për mu edhe për të tjerët.

5 Py. Çfarë mund të na thoni për dhomën sipër, kur ju çonin në
6 katin sipër? Tek dhoma sipër çfarë ndodhte atje?

7 Pë. Atje ndodhte një rrehje që s'mund me merr me mend dikush,
8 shumë brutale.

9 Py. Dhe përdorimi i këtyre instrumenteve, gjërave që ju thatë
10 si për shembull qiriu, kutia e rrymës - të gjitha këto
11 ndodhnin tek dhoma sipër me sa kuptova apo jo?

12 Pë. Po, po lart kanë ndodhur.

13 Py. A ju kujtohet sesa njerëz ishin të përfshirë në këto
14 rrahjet tuaja?

15 Pë. Po ka ndodhë tre-katër, ka ndodhë edhe pesë me konë. Varet
16 se ka njëherë do shkojshin, do mbetshin, varet.

17 Py. A ju kujtohet n.q.s. bëhej fjalë për të njëjtët ushtarë që
18 ju rrihnin, apo ishin ushtarë të ndryshëm?

19 Pë. S'ka ndodh me qenë ushtarë të ndryshëm, që ato që janë
20 konë që aty në q'atë send, po d.m.th. këta torturusët janë
21 konë të njofshëm për të gjithë neve.

22 Pë. Kur keni qenë aty në ahur, në stallë, rrahjet apo
23 keqtrajtimet kanë ndodhur para personave të tjerë, të cilët po
24 ashtu mbaheshin të ndaluar aty?

25 Pë. Po.

1 Py. Dhe kur ju dërgonin merreshit individualisht, d.m.th.
2 merreshe vetëm ti apo merreshit si grup dhe dërgoheshit? Po
3 ashtu ju lutem dua t'ju rikujtoj sërish që jemi në seancë të
4 hapur, kështu që ju lutem mos përmendni emra.

5 Pë. Okej. Jo, kur të marrshin për nalt ti je konë. Veç vetë të
6 kanë marrë, jo kështu grup. Na kanë marrë ka një ka një.

7 Py. A e dini apo keni dëgjuar emrat apo nofkat e personave, të
8 cilët kanë qenë në përfshirë në rrahjet dhe keqtrajtimet
9 tuaja?

10 Pë. Po, disa emra, nofka i mbaj mend. Më kanë mbetë në kry.

11 Py. A mund të na thoni se cilat ishin këto emra ose
12 pseudonime?

13 Pë. Po ka qenë, ato sa mbaj mend, ka qenë një pseudonim,
14 Tabuti, ka qenë Ilmi Vela. Ka qenë një Afrimi, një tjetër me
15 emrin Dardan, një [REDAKTUAR] se ishin ashtu, ka qenë
16 [REDAKTUAR]. Këta janë kenë ata torturusit që më kanë mbetë në
17 kry. Këta janë konë ata maltrajtusit që kanë ekzistuar aty, ma
18 të mëdhenjtë. Ka pasë edhe të tjerë që kena dëgju emra Avni,
19 Bujari, po nuk kena pasë keqtrajtime prej atyne. Keqtrajtimet
20 kanë qenë që prej ktyne emrave që i përmenda.

21 Py. Në rregull. A ju kujtohet se çfarë kishin veshur këta
22 persona, d.m.th. a ishin të veshur me uniforma, a ishin veshur
23 me rroba civile? Ju kujtohet gjë?

24 Pë. Po, këta i kanë pasë rrobat e zeza kështu, po ka ndodhë
25 nanjiherë që janë konë normal, me tesha kështu normal, me

1 farmerka. Zakonisht janë konë me uniformë, që atë uniformën e
2 tyre.

3 Py. Ato herë që kanë qenë të veshur në uniformë, a mbani mend
4 detaje të tjera, hollësi të tjera sa i takon këtyre uniformave
5 për shembull informacion njohës, ose le të themi shënime të
6 caktuara në to? A ju mbahet mend ndonjë gjë tjetër sa i takon
7 këtyre uniformave të zeza?

8 Pë. Kom mbajt mend, kanë pasë disa emblema si me një shqiponjë
9 BIA ashtu, këtu qa mujt me mbajt mend.

10 Py. Ju përmendët një emër Tabuti. A mban mend ndonjë pseudonim
11 lidhur me këtë person?

12 Pë. Jo, ashtu e kanë thirr Tabut. Po masnej, mbas një kohe,
13 nëse s'gaboj, kom digju që e ka emrin Nazif.

14 Py. Dhe a e dini se n.q.s. kjo nofkë, Tabuti, a ka ndonjë
15 kuptim? A e di se çfarë kuptimi ka kjo nofkë?

16 Pë. Kjo nofkë nuk e di. Na i thojna "tabut" kur vdes njeri e
17 qesin në to dhe e çojnë te vorret. D.m.th. nuk di çka mundet
18 me përmbajt kjo farë nofke.

19 Py. A do të thuash që "tabut" do të thotë arkivol me aq sa e
20 kupton ti?

21 Pë. Me aq sa kuptoj unë q'ashtu është.

22 Py. Të nderuar Gjykatës tani do të kaloj në një fushë, ku do
23 të bëjë pyetje të cilat mund të çojnë në nxjerrjen e
24 identitetit të dëshmitarit dhe të dëshmitarëve të tjerë të
25 mbrojtur, kështu që do ju kërkoja që të kalonim në seancë

1 private.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e
3 nderuar Prokurore, e kuptoj argumentin tuaj. E nderuar
4 Sekretare, të lutem a mund të kalojmë në sesionin privat?

5 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar jemi në
7 sesion privat.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull.

10 Znj. Prokurore ju lutem vijoni më tej.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Z. Dëshmitar, tani dua t'i
12 kthehem momentit të parë kur ti je dërguar në ahur, në
13 momentin kur keni arritur atje. Unë ju pyeta pak më parë dhe
14 ju thashë n.q.s. gjete persona të tjerë kur ju dërguan në
15 ahur, dhe përgjigjja që ju më dhatë ishte, "Po, që kishte
16 persona të tjerë." Kjo jepet në faqen 32, rreshti 10 i
17 transkriptit të ditës së sotme.

18 Tani jemi në sesion privat që kështu ju mund të jepni
19 emra dhe hollësi të tjera. A mund të na tregosh ju lutem se
20 kush ishin personat e tjerë që ju gjetët në ahur në moment kur
21 arritët atje. Pra, si quheshin ata dhe gjëra të tjera që
22 mbanit mend rreth këtyre personave.

23 Pë. Po, sa më kujtohet kur më kanë çu aty, ka qenë një

24 [REDAKTUAR], ka qenë [REDAKTUAR], ashtu

25 e quheshin, ashtu i thojshin [REDAKTUAR], ka qenë [REDAKTUAR]

- 1 [REDAKTUAR]. Po tani ndërkohë kanë pru edhe tjetër.
- 2 Py. A i njihje nga më përpara këta persona apo jo?
- 3 Pë. Aty jom ngoftë me ta, aty jam pa, aty jam njoftë për herë
- 4 të parë në atë vend.
- 5 Py. Edhe si i mësove ti emrat e tyre?
- 6 Pë. Po, ndërkohë t'u bisedu nga pak se u tutshim me bisedu.
- 7 Ata kanë tregu se kush janë edhe u kom tregu se kush jam.
- 8 Py. Sa persona gjetët ju atje kur mbërritët? Vetëm këta
- 9 persona të cilët ti i përmende, apo edhe persona të tjerë?
- 10 D.m.th. thjesht po jua bëj këtë pyetje sepse ju thatë që
- 11 kishte njerëz që dilnin dhe vinin të rinj. N.q.s. e mbani mend
- 12 si mund t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje?
- 13 Pë. Kësaj pyetje ju kisha përgjigj unë me sa mbaj mend kur kam
- 14 hy, këta njerëz që përmenda i kam gjetë aty. Edhe mbas,
- 15 ndërkohë, këta kanë pru njerëz aty dy ditë, tri ditë edhe i
- 16 kanë largu.
- 17 Py. A i mbani mend emrat e personave të tjerë të cilët janë
- 18 sjellë në stallën, gjatë periudhës që ti ke qëndruar aty në
- 19 stallë?
- 20 Pë. Po, ka qenë një, sa e mbaj mend, një [REDAKTUAR], edhe
- 21 një e thirrshin këta [REDAKTUAR] i thojshin këta atij djalit.
- 22 Një djalë i ri edhe ai. Ashtu e thirrshin [REDAKTUAR]. Emnin
- 23 nuk ia di. Se ai u tutke me fol edhe me neve.
- 24 Py. A ju ka ndodhur atyre ndonjë gjë, d.m.th. këtyre
- 25 personave, emrat e të cilëve ti përmende? A ju ka ndodhur

1 ndonjë gjë ndërkohë që ata mbaheshin aty në stallë?

2 Pë. Ju ka ndodhë që ajo ça më ka ndodhë mu, që këto tortura që
3 këto sende sikur mu, të njëjtën, të njëjtin send.

4 Py. Sa shpesh rriheshin këta personat e tjerë? D.m.th. sa herë
5 rriheshin ose keqtrajtoheshin ata? D.m.th. çfarëdolloj gjëje
6 që ti mund të kesh parë me sytë tuaj? Sa shpesh ndodhte një
7 gjë e tillë?

8 Pë. Po kjo që në fillim ka qenë për secilin njëjtë. Çdo ditë
9 na rrihnin rëndë.

10 Py. Këta personat e tjerë a rriheshin para syve tuaj? A e keni
11 parë vetë këtë gjë me sy të tuaj ndërkohë që ishit në stallë?

12 Pë. Aty ka mujt me ndodhë nonji boks, ndonji shkelm që thashë
13 ma herët, po këta zakonisht na marrshin, na çojshin lart për
14 me i rreh kështu siç dojshin këta vetë, i çojshin lart.

15 Py. Dhe a mundeshit ju të dëgjoni se çfarë po ndodhte sipër,
16 lart që thoni ju, ndërkohë që merreshit nga ahri dhe
17 dërgoheshin sipër, te dhoma sipër?

18 Pë. Po. Mujsha me digju. D.m.th. aty kom ndi zona, lloj-lloj
19 zoni kom ndi. Që aty kom pa në jetën tem që njeri i ndërron
20 dhjetë zona prej maltrajtimeve. Dhe i ke ndi poshtë krejt.

21 Py. Çfarë lloj zërash mundnit të dëgjoni ju kur ishit poshtë?
22 Ju kërkoj ndjesë sepse po ju kërkoj që të futeni në hollësi
23 specifike, por mendoj që kjo është e rëndësishme për neve për
24 ta kuptuar plotësisht se çfarë ka ndodhur aty.

25 Pë. Okej, s'ka problem znj. Prokurore. Ke ndi zona për

1 shembull ke ndi zona të njerëzve t'u bërtit "au", kështu, t'u
2 bo si qenë, si macja. Unë aty kom pa ato zona, ato i kam ndi
3 prej torturës, prej dhimbjeve. Se unë ndoshta kom bo dhe vetë
4 ashtu, por kur po e dëgjojshe dikënd ishte shumë keq.
5 Py. E kuptoj. Ju falënderoj për këto hollësi. Z. Dëshmitar,
6 keqtrajtimet a kanë ndodhur gjatë natës? Pra ju
7 keqtrajtoheshit vetëm gjatë ditës dhe jo gjatë natës, apo edhe
8 gjatë ditës edhe gjatë natës, e mbani mend këtë gjë?
9 Pë. Jo, kjo ka ndodhë edhe gjatë ditës edhe gjatë natës, kur
10 kanë dashtë ata vetë. Kur kanë dashtë janë ardhë e kanë çel
11 derën, e kanë marrë dikënd në duarsh, e kanë çu e kanë rreh pa
12 problem, kur kanë dashtë vetë.
13 Py. Në çfarë kushtesh i keni parë njerëzit që ju çonin juve
14 lart, tek dhoma lart, që t'ju merrnin nga ahuri? D.m.th. në
15 çfarë gjendje i shikonit juve ata kur ktheheshin në ahër dhe
16 merrnin dikë tjetër dhe e çonin sipër?
17 Pë. Ata, secili na ka çu nalt me nalt, na kanë rreh, kur na
18 kanë kthy, na kanë kthy veç të alivanosun q'ashtu. Edhe çdo
19 njeri që e kanë pru ne jena mundu me e ndihmu pak a shumë, me
20 e marrë me e mbështet që aty, për zidi, pak, me e mbulu. Jonë
21 konë do qebe si të forta kështu pak me e mbulu. Jena mundu me
22 i ndihmu njoni-tjetrin ma shkurt. Në gjendje të mjerueshme.
23 Py. Tani unë do të kaloj person pas personi. Pra do t'ju bëj
24 pyetje të cilat kanë të bëjnë me keqtrajtimet që janë bërë mbi
25 secilët nga personat që ju përmendët me emër, të cilët juve i

1 keni parë me sytë tuaj. Dhe sërish më lejoni të them që kjo
2 është pjesë e vështirë për juve, por e vlerësojmë shumë
3 ndihmën tuaj. A mund të na thoni ju lutem që çfarë keni parë
4 t'i ketë ndodhur [REDAKTUAR]?

5 Pë. Po mujt me thonë se ai ka qenë një ndër të dëmtumit ma të
6 mëdhenj. Ka qenë një njeri i keqtrajtum mizorisht.

7 Py. Ju lutem a mund të na thoni se çfarë mbani mend apo çfarë
8 keni parë që t'i ketë ndodhur atij. Pra n.q.s. kishte shenja
9 në trup apo gjëra të tjera të cilat justifikojnë përshtkrimin
10 që ju thatë pak më sipër që ai është keqtrajtuar në mënyrë
11 brutale.

12 Pë. Po, ai ka qenë në mënyrën më të keqe të mujtshme. Prej
13 krejt neve ka qenë ai ma së shumti. D.m.th. ai ka pasë, ka
14 pasë shenja shumë, ka pasë sende. Ato edhe e kanë susë, kur e
15 kanë çu nalt e kanë susë me hekur të nxehtë, me thikë të
16 nxehtë. D.m.th. ai u konë, u konë diçka katastrofë u konë ai,
17 tmerr asht ajo çka u konë ai. Trupin e tijna asht tmerr. Ne
18 jena konë krejt të rrehun sende, po ne ato si kena pasë. Ai u
19 konë katastrofë, ai u konë një gjendje, masakër asht ajo
20 domethënë.

21 Py. [REDAKTUAR]

22 n.q.s. e mbani mend?

23 Pë. [REDAKTUAR] se

24 ai edhe [REDAKTUAR].

25 Py. A ju kujtohet sesi ishte [REDAKTUAR] ai dhe çfarë do të

1 thuash ti me këtë? Mund të na i shpjegosh pak më tej?

2 Pë. Po ai zakonisht e kanë mbajtur [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR] edhe u kapte me ta,

4 edhe i njoftoi se gjysmën e tyre i kish pasë shokë. Edhe këta

5 edhe [REDAKTUAR]. D.m.th. se ai kundërshtoi,

6 çdo herë ka kundërshtu derisa kohën e funit s'kish më as fuqi.

7 Py. Dhe a ishte ndonjë person tjetër [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]?

9 Pë. Veç ai ka qenë. Krejt jena konun zgjidhun, veç ai u konë
10 lidh.

11 Py. A keni folur me [REDAKTUAR]? A e keni kuptuar juve se

12 të paktën ai a ju ka thënë ndonjë gjë sepse ishte i mbajtur?

13 Pse mbahej aty?

14 Pë. Sa më kujtohet mu, ato fjalët e tijna se ky më tha se
15 paska qenë një hajdut edhe për atë punë e paskan marrë.

16 Py. Pra po thoni që ai besonte se kishte një arsye sepse ishte
17 dërguar atje?

18 Pë. Po këta që e akuzojshin, d.m.th. i thonin "ti je hajn, ti
19 je idiot!" ksi sendesh. Që aty edhe ai vetë thojke më kanë
20 marrë për këtë punë, më thonë hajn. Sa kemi mujt me bisedu aty
21 brenda.

22 Py. Mirë në rregull. Faleminderit që na e sqaruat këtë. Pra ai
23 tha që atij i kishin thënë që akuzohej se ishte hajdut.

24 Pë. Po.

25 Py. Ju përmendët se ai i njihte njerëzit që ishin aty dhe ata

1 ishin shokët e tij? A kam të drejtë? Është e saktë kjo? A
2 thatë ju pak më përpara që [REDAKTUAR] personat që ishin
3 atje në ahër?

4 Pë. Po, ai shumicën e këtyne i ka njoftë.

5 Py. A ka thënë ndonjë gjë ai lidhur me këta persona? A ka
6 përmendur se kë njihte, se si quheshin ata? Nuk e di a mbani
7 mend ndonjë hollësi lidhur me këtë çështje?

8 Pë. Po, këta zakonisht kur e kanë marrë me e rreh që e
9 akuzojshin si hajdut, i thojshin se [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR] Ai u thojke, "po ti ke vjedh me mue." Ai u thojke
11 ndër sy se, "bashkë kena vjedhë." Edhe aty e kom pa që i
12 ngjihte krejt. Edhe neve na ka tregu në ahër sa kemi qenë. Na
13 ke tregu [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR].

15 Py. [REDAKTUAR] a ka përmendur me emër ose me nofkë ndonjë
16 person tjetër të cilin ai e njihte nga më përpara? Pra para
17 sesa të dërgohej atje.

18 Pë. Po ai i përmendke të gjithë gati, pothujse i ngjofke

19 [REDAKTUAR] e

20 ka përmend. Edhe ai i njihte. Në përgjithësi i njihte këta
21 njerëz.

22 Py. Tani do t'ju pyes rreth [REDAKTUAR]? A keni fol me të
23 dhe a e keni kuptuar arsyen sepse ai mbahej i ndaluar atje?

24 Pë. Po, edhe me të kam bisedu. Ai në atë kohë kish qenë në

25 [REDAKTUAR] kështu. Edhe kish qenë si [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR] diçka. E kish pasë atë pozicionin e
2 vet. Edhe kish ardhë me dhënë [REDAKTUAR],
3 këta e kishin marrë e kishin shti brenda dhe e rrehshin. Ky
4 kish ardhë me [REDAKTUAR], nëse s'gaboj do
5 [REDAKTUAR] janë konë në pyetje, diçka me ju [REDAKTUAR].
6 Këta e morën e kishin shti brenda dhe e maltrajtojshin kështu.
7 I thojshin se [REDAKTUAR],
8 ku ta di unë, ksi sende.
9 Py. Kur thatë që [REDAKTUAR]
10 [REDAKTUAR] ta, a na e sqaron pak të lutem se çfarë do të
11 thuash kur thua "ata"?
12 Pë. Po unë mendoj na me kujtu çfarë më ka thonë [REDAKTUAR]
13 vetë mu kur kam bisedu me të. Kish ardhë me ja u pru
14 [REDAKTUAR] këtyne ushtarëve. Edhe këta ja kishin marrë
15 [REDAKTUAR]
16 [REDAKTUAR].
17 Py. Dhe çfarë patë juve t'i ketë ndodhur [REDAKTUAR]
18 n.q.s. ke parë ndonjë gjë? A është keqtrajtuar dhe [REDAKTUAR]
19 [REDAKTUAR]?
20 Pë. Po, ai është keqtrajtu. Aty janë konë të keqtrajtum krejt,
21 në përgjithësi jena konë krejt.
22 Py. Edhe atë e kanë dërguar sipër, te dhoma sipër n.q.s. të
23 kujtohet?
24 Pë. Po, po, po.
25 Py. Dhe kur e kanë keqtrajtuar, kur ka ndodhur? Ka ndodhur

1 edhe në stallë aty përpara syve të tuaj? E keni parë vetë me
2 sytë tuaj këtë gjë?

3 Pë. Jo, në stallë, në stallë unë di, nuk e kanë keqtrajtu atë.
4 Zakonisht nalt. Po në stallë jena keqtrajtu për shembull, unë,
5 [REDAKTUAR] e mbajshin e
6 çojshin d.m.th. nalt. Aty nuk ka ndodh aty ndër sy neve,
7 [REDAKTUAR] nuk e kanë rreh. Veç a konë, a konë i keqtrajtum
8 edhe ai.

9 Py. A të kujtohet se si kthehej pasi e çonin tek dhoma lart,
10 d.m.th. kur e kthenin në atë stallë? Ç'pamje kishte? Në
11 ç'gjendje vinte?

12 Pë. Vinte me një gjendje shumë, shumë të mjerueshme si secili.

13 Py. Do të të pyes tani për [REDAKTUAR]? A ke fol me atë? A e
14 di se përse ndodhej ai aty?

15 Pë. Po edhe ai sa kom kuptu që kështu më ka tregu ai tash.

16 Edhe ai kish ardhë me [REDAKTUAR]. Kish
17 ardhë me u kyç në luftë. Këta ja kishin zënë, ja kishin marrë
18 që atë [REDAKTUAR] i
19 kishin thonë, t'i je spiun. E kishin pru dhe e torturojshin
20 aty te neve.

21 Py. Edhe njëherë të njëjtat pyetje siç t'i bëra përpara.

22 [REDAKTUAR] a e keni parë që ta rrehnin në stallë, në sytë
tuaj?

23 Pë. Po, ka ndodhë.

24 Py. Të kujtohet nëse edhe atë e çonin tek dhoma lart?

25 Pë. Po, patjetër. Atë e kena pasë secili me rend.

1 Py. Të kujtohet se në ç'gjendje e sillnin, e kthenin prapë

2 poshtë mbasi e çonin aty lart?

3 Pë. Edhe ai të njëjtin, të njëjtin send. Në gjendje shumë të

4 keqe, të rëndë d.m.th. prej maltrajttimeve, prej torturave

5 njeri edhe u lodhke. As se mbajshin as komtë.

6 Py. Përmende edhe një person me emrin [REDAKTUAR]. Si e kishte

7 emrin dhe mbiemrin?

8 Pë. Mbiemrin nuk e di, ata e thirrshin [REDAKTUAR], ashtu.

9 Mbiemrin nuk ia di. Edhe atë e kam taku aty kam bisedu me të.

10 Py. The që ke bisedu me të. A e kuptove sepse ishte ai aty,

11 pse e kishin çu aty?

12 Pë. Po, mbas fjalëve të tijna që na ka thonë edhe çka ndijshim

13 na aty prej tynve, ky kish qenë, [REDAKTUAR], dhe

14 i thojshin se ti je bashkëpunëtor. [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR], ku ta di unë, ksi sende. Thojshin si

16 bashkëpunëtor i serbëve diçka.

17 Py. E ke parë këtë që ta rrihnin apo ta maltrajtojnë aty në

18 stallë? E kam fjalën për [REDAKTUAR].

19 Pë. Po, por edhe këtë e kanë rreh edhe në stallë, edhe nalt.

20 Të vetmin [REDAKTUAR] nuk e kam pa që e kanë torturu në

21 bodrum. Po neve të tjerëve, ne jena konun, sa herë kanë ardhun

22 ne jena konë ose ndonji shkelm, ose ndonji boks ose diçka pa

23 marrë parasysh, s'ke pështu kurrë pa diçka. Edhe ky a konë i

24 torturum shumë.

25 Py. Këto zërat që dëgjoje, që the që i dëgjoje kur i çonin

1 njerëzit lart, në dhomën lart, i dëgjoje këta zëra, sa herë që
2 personat që përmende -- për shembull, kur [REDAKTUAR] e çonin
3 lart, tek dhoma lart. A mund të na i përshkruash këto tinguj,
4 këto zëra që i përmende pak më parë?

5 Pë. Po, këta zëra i ke digju, gjithkënd e kanë çu lart. Ose ka
6 pasun aty, kanë pru edhe njerëz të tjerë, jo veç. Nuk kemi
7 konë veç na aty, po kemi dëgju zëna të njerëzve të tjerë.

8 Py. Këto shenjat e maltrajtimit që i përmendët, ia ke parë
9 këto shenja, ia ke parë pra [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR], saktë?

11 Pë. Po, i ke pa se ata zakonisht, ne jena konë edhe të
12 Gjakovës jena konë, edhe krejt njeri shihet në do shembuj. Ne
13 jena konë në gjendje të mjerueshme jena konë krejt. D.m.th.
14 edhe ato shenjat shihen nëse ty të ka rrjedh gjak fytyrës ose
15 në kry ose, ato u pajshin.

16 Py. Z. Dëshmitar, përmende dhe dikë me emrin [REDAKTUAR].

17 Me këtë a folët bashkë, a e kuptove pse ishte aty?

18 Pë. Po edhe këtu ky s'ka nejt shumë gjatë me neve, tri ditë
19 katër a s'di. S'ka nejt ma shumë. Edhe këta e akuzojshin si
20 bashkëpunëtor, bashkëpunim me serb ai. [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR] e i thojshin, [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR] Kështu e akuzojshin, një farë akuze si
bashkëpunëtor.

23 Py. Emrin nga ja ia mësove? E njifje nga përpara apo ia mësove
24 aty emrin?

25 Pë. Jo, unë e kom pa dhe ndoshta dhe përpara atë [REDAKTUAR],

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari W01679 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Znj. D'Ascoli
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 53

1 e kam njoftë ama mbiemër s'kam ditë, po aty e kam mësu emrin
2 dhe mbiemrin e tijna kështu saktë prej tijna. E kam mësu këtu
3 edhe për çka po akuzohet, për çka e torturojshin këta. Aty e
4 kam kuptu

5 Py. Z. Dëshmitar, pak më herët sot, në faqen 24, rreshti 4 i
6 transkriptit, 34, faqja 34, rreshti 4 i transkriptit, the që
7 edhe të kanë urinuar. Ke parë që këtë t'ia bëjnë edhe të
8 tjerëve, këtyre personave të tjerë që përmende?

9 Pë. Unë nuk i kom pa, ndoshta ka mujt me ndodhun aty sa janë
10 konë nalt ose diçka, po unë nuk i kom pa. Mu më kanë urinu
11 ndër sy të krejtve, d.m.th. mu më ka ndodh edhe në bodrum edhe
12 nalt që më kanë urinu këta.

13 Py. E bëra këtë pyetje sepse e ke përmendur një emër në
14 dëshminë që ke dhënë përpara.

15 ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës nëse mund
16 t'i mbështetem tek ajo pjesë e transkriptit të ZPS-së për t'ia
17 rifreskuar kujtesën dëshmitarit lidhur me këtë çështje.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
19 mund të vazhdoni.

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

21 Py. Z. Dëshmitar, gjatë intervistës me Zyrën e Prokurorit
22 të Specializuar, u bë pyetja nëse ju kujtohet, nëse ka urinuar
23 edhe mbi dikë tjetër. Ju keni thënë, dhe unë do të lexoj nga
24 anglishtja, që të mos ta sjellim transkriptin. Referenca e
25 transkriptit është 060698-TR-ET, Pjesa 3, e Rishikuar, RED3.

1 Është nga - Nënndarja Nr. 3. Të gjitha transkriptet janë me
2 nga Nënndarja Nr. 3 e listës të dokumenteve të dëshmitarit.

3 Në faqen 6, në rreshtin 9 deri në 10, i jeni përgjigjur
4 pyetjes kështu, "Po, në aëur. Po sepse për shembull unë isha
5 afër [REDAKTUAR] dhe ai urinoi -- dhe ky personi na urinoi të
6 dyve neve."

7 Dhe pastaj pyetjes tjetër që t'u bë, është që, "Kush ua
8 bëri këtë gjë?" Ti [REDAKTUAR]".

9 Të rikujtohet tani? A t'u rifreskua kujtesa?

10 Pë. Po, unë kështu po du me të tregu ty se unë
11 drejtpërsëdrejti sikur qysh ma kanë bo mu nuk e kom pa që ja
12 kanë bo dikujna. Se ai, është gjë normale ai u konë afër meje,
13 ka mujt edhe ai me u urinu kështu ama, kështu drejtpërsëdrejti
14 sikur qysh ma kanë bo mund nuk e kam pa që iu kanë orientu
15 dikujna ashtu direkt. Apo është e vërtetë kom qenë afër
16 [REDAKTUAR], ka mujtun edhe ai me përjetu ato sikur unë. Nuk
17 ka pasë aty kontroll.

18 Py. D.m.th. e ke fjalën që nga që ishin ulur pranë e pranë
19 atëherë edhe u urinuan edhe atë domethënë?

20 Pë. Po, është e mujtshme, po. Që ashtu kom desht me thonë
21 këto, po ka sende që s'kom mujt me u kuptu me Prokurorin e juj
22 shumë. Se në bazë të asajna që thashë më herët, që asaj
23 deklarate kom kenë edhe pak nervoz. S'kom mujt me i kuptu do
24 gjona shumë. E kështu kom desh me thonun se jom kenë afër
25 tijna, po kështu nëse kam pa dikënd që kanë shku drejt e me bo

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari W01679 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Znj. D'Ascoli
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 55

1 që atë punë, qysh ma kanë bo mu. Se mu më kanë rreh, më kanë
2 alivanos dhe jam kenë afër [REDAKTUAR] aty. Edhe më kanë
3 urinu, më kanë thonë, "Qe uji!".

4 Py. Faleminderit z. Dëshmitar. Tani është e qartë. Pra ishit
5 ngjitur aty pranë e pranë me [REDAKTUAR] kur ju urinuan
6 juve. Edhe ky ishte dhe sqarimi që na e dhatë sot. E saktë? E
7 përmblodha mirë?

8 Pë. Ashtu jam mundu edhe unë me tregu këtë send. Sa e keni të
9 kjartë nuk e di, veç jam mundu me tregu kështu.

10 Py. Është e qartë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Desha
12 t'i përsëris Dëshmitarit se për këtë çështje na ka sqaruar
13 mjaft. Ju falënderoj shumë.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

15 Py. Z. Dëshmitar, keni dëgjuar për dikë me emrin [REDAKTUAR]
16 [REDAKTUAR]? E njeh këtë emër?

17 Pë. Jo, s'po më kujtohet. [REDAKTUAR].

18 Py. Znj. Sekretare, ju lutem të nxirrni në ekran, dokumentin
19 me numër 13 në listë e provave, ERN-në e përmendur aty të
20 parën, që është SPOE00127846 deri në 00127847, RED. Më
21 nevojitet faqja numër 2 ju lutem, nëse znj. Sekretare mund ta
22 zmadhojë foton që ndodhet aty në mes.

23 Py. Z. Dëshmitar, përpara keni një fotografi në ekranin që
24 keni përpara. Shiheni ju lutem. Është fotoja e një të riu. Kjo
25 fytyrë a të kujtohet? A e ke parë ndonjëherë këtë fytyrë? A e

1 njuh këtë të ri?

2 Pë. Ndoshta e kam pa, nuk jam i saktë. S'më kujtohet kurrëgjjo.

3 S'po më lidh kurrëgjjo diçka.

4 Py. Kur thua "mbase", na e sqaron pak pse thua "mbase"? Dhe

5 nëse mbase e ke parë, ku mund ta kesh parë?

6 Pë. Është e mujtshme ndoshta ka qenë në një farë kampi ku jena

7 konë na, në këtë farë stalle, ka mujt. Si e njofshme pak po

8 nuk po ma kujton. Nuk po ma kujton diçka saktë çka me të thonë

9 për këtë foto.

10 Py. Nuk ka problem. Është në rregull. Mund ta heqim dokumentin

11 nga ekрани.

12 Py. Z. Dëshmitar, mes njerëzve që ishin aty në stallë

13 përmendët edhe një emër, apo edhe një nofkë [REDAKTUAR], e
saktë?

14 Pë. Po.

15 Py. Nga ishte [REDAKTUAR]? A e more vesh ndonjëherë?

16 Pë. Nuk e di. Sa na ka tregu veç që jam prej anës [REDAKTUAR]

17 dikund. Nuk ka bisedu ma shumë me neve se ky jo që u tutke

18 prej atynve po ky u tutke edhe prej neve. Ky mu duk sikur mos

19 me konë njëri në rregull normal kështu. Nuk bisedojke me neve

20 kurrë.

21 Py. Ç'do të thuash kur thoshe nuk u dujke njeri normal nëse

22 mund ta sqarosh?

23 Pë. Po s'mu dukte njeri normal se ai njeri kurrë nuk

24 bisedonte, veç si me trauma, t'u u dridh, nuk e llogariti

25 njeri normal. Krejt kena bisedu aty, d.m.th. ai kurrë nuk u

1 kyç me neve as me bisedu, as ka dashtë me bisedu, as kurrëgjjo.

2 Py. A të kujtohet ndonjë gjë tjetër? Për shembull sa vjeç, sa
3 vjet i kishte përafërsisht?

4 Pë. Ça me thonë ka qenë ndoshta nja dy vjet tre ma i madh se
5 unë. [REDAKTUAR]. Përafërsisht po them se nuk e di. Veç
6 e di që ka qenë djalë i ri. Sa vjeç nuk e di. Po e lë
7 përafërsisht 20-21.

8 Py. Ju kuptoj. Po këtë a e kanë rrahur, e kanë maltrajtuar si
9 gjithë ju të tjerët? A i ke parë që e kanë rrahur dhe
10 maltrajtuar?

11 Pë. Po, po. Edhe këtë e kanë rrahur e kanë çu, shpeshherë nalt
12 e kanë çu. Edhe e kanë rreh edhe brenda edhe në stallë e kanë
13 rreh sikur krejt të tjerët. I vetmi është [REDAKTUAR] që s'e
14 kanë rreh në stallë. Krejtve d.m.th. na kanë rreh edhe në
15 stallë edhe nalt. D.m.th. të njëjtin send e kena pasë krejt.

16 Mirë. Të nderuar Gjykatës mendoj se mund të rikthehemi në
17 seancë të hapur. Desha t'ju pyes a të vazhdoj të bëj pyetje
18 deri në orën 1 pa një çerek, apo deri në orën 1? Është pyetje
19 që ka të bëjë me pushimin e radhës.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit znj. Prokurore. Më kanë informuar se mund të
22 vazhdojmë deri në orën 1. Kështu që keni përafërsisht edhe
23 treçerek ore për të vazhduar me pyetjet tuaja.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit që më informuat.

25 Mund të rikthehemi në seancë të hapur.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

2 Sekretare, ju lutem të rikthehemi në seancë të hapur.

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi rikthyer në seancë
5 të hapur.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit znj. Sekretare.

8 Dhe znj. Prokurore mund të vazhdoni.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
10 Gjykatës.

11 Py. Z. Dëshmitar, dëshiroj tani që t'u kthehem kushteve në të
12 cilat keni qëndruar gjatë ndalimit. Sa i takon ushqimit, a ju
13 jepnin ushqim të mjaftueshëm gjatë ditëve kur ju kanë mbajtur
14 të ndaluar?

15 Pë. Ushqim. Ushqim kemi pasë një herë në dy ditë, në tri ditë.
16 Ndoshta një copë të vogël. Ai e ka pru, s'kam -- me ta spjegu
17 pak, një, sikur me thonë që tashti -- gjys buke ne e kena nda
18 q'atë në gjashtë pjesë, pesë pjesë, sa persona jena konë aty.
19 Ata ta kanë pru çdo dy ditë. Ka ndodhë që edhe të tretën.

20 Py. Po ujë? Ujë a ju jepnin mjaftueshëm me pi?

21 Pë. Jo, as ujë. Unë u mundova me ta spjegu edhe ma herët. Unë
22 sherrin që lypa ujë, edhe më alivanosën edhe ma kryjtën atë
23 farë pune. As ujë, as kurrigjo, edhe s'ke guxu me lypun që ajo
24 asht më e keqja.

25 Py. Po kushtet e gjumit, e fjetjes, mund t'i përshkruani?

1 Pë. Kushtet e gjumit në tokë. Kena pasë nja, nëse s'gabo
2 nja tri qebe diçka, kanë qenë. Po d.m.th. ka pasë pak kashtë
3 ça u ka mbetë aty-këtu edhe në tokë, në gurë, në dhe, ça ka
4 pasë q'ajo. Se ka ndodhë ato qebe ja kena dhonë njoni-tjetrit
5 për me u mbulu pak, që u jonë konë ma keq, se u konë nirdht,
6 do shembull. Po ma thjesht në tokë, në dhe, në gurë, në
7 lagështi. Këto kanë qenë disa kushte ça muj me i mbajt mend.
8 Py. Po për t'u larë, a mund të laheshit gjatë atyre ditëve që
9 ju kanë mbajtur në ahur?

10 Pë. Jo, znj. Prokurore, ujë me pi s'na kanë dhonë, se le me u
11 la.

12 Py. Po me shku në tualet, me kry nevojat?

13 Pë. Po, edhe për këtë pjesë e kena pasë një kovë aty brenda në
14 stallë. Q'aty e ke kry nevojën.

15 Py. Të njëjtën kovë ishit të detyruar të përdornit të gjithë
16 aty në stallë?

17 Pë. Po, po krejt.

18 Py. Dhe urinonit apo, pra bënit ujtë e hollë edhe ujtë e
19 trashë përpara njëri-tjetrit?

20 Pë. Q'aty. Q'aty brenda në stallë.

21 Py. A mori ndokush prej jush ndonjë kujdes mjekësor gjatë
22 kohës që ishit aty?

23 Pë. Jo.

24 Py. A jua mjekoi kush plagët pasi ju rrifshin?

25 Pë. Jo, jo. Veç njoni-tjetrit ça kena mujt me ndihmu me diçka,

1 se jo.

2 Py. A kërkuat ju, a kërkoit dikush prej jush kujdes mjekësor?

3 Pë. Jo, znj. Prokurore, aty nuk e guxoftë - të thashë edhe ma

4 herët - me lypun ujë me pi se le më tjetër send. Se çka ke

5 kërku d.m.th. veç e ke pasë, veç ja ke shtu vetit kënd rreh më

6 shumë, kurrëgjjo tjetër.

7 Py. Ju kanë lejuar që të kontaktoni apo t'i dërgoni fjalë

8 familjes?

9 Pë. Jo, jo.

10 Py. Si jeni ndier gjatë atyre ditëve kur ju kanë mbajtur në

11 ahër?

12 Pë. Po si mund të ndjehesh?! Je ndje shumë keq edhe ke prit

13 veç vdekjen, por, kur po të vjen. Kurrëgjjo s'ke pasë ça mujt të

14 di as ça me mendu tjetër, veç e ke prit, as sot, nesër, kur po

15 të mytin.

16 Py. Kalojmë tani tek lirimi. A mund të na thoni se si ju

17 liruan? Si ndodhi që ju liruan?

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 Py. Do t'ju pyes më vonë me hollësi për emrat kur të jemi në

22 seancë private. Meqenëse jemi në seancë të hapur ju lutem mos

23 harroni që të mos përmendni emra siç vepruat. [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 Pë. Sa më kujtohet ka qenë nëse s'gaboj që ai [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 Py. Patë persona të tjerë jashtë qofshin ushtarë apo civilë?

7 Pra jashtë ahurit kur ju liruan.

8 Pë. Ka pasë disa që kanë ba roje ose ushtarë të tynve që kanë
9 qenë ma poshtë, ma nalt. Ka pasë, ka pasë njerëz.

10 Py. A jua treguan arsyet përse po ju lironin?

11 Pë. Jo. Unë e pyta këtë [REDAKTUAR]. I thashë, "Bon me më
12 tregu pse

13 më keni mbajt?" I thashë "Që ktu?" Më tha, "E ke babën e ke të
14 keq" tha "edhe vazhdo ec, mos e zgjat ma shumë." Edhe vazhdum.

15 Py. Po ndonjë dokument lirimimi a ju dhanë?

16 Pë. Jo, jo kurrgjo, nëse s'gaboj një, do toja të patikave edhe
17 një rryp, q'ato ça mi kanë marrun në fillim. Kur mi kanë
18 marrë, tani që ato mi dhanë edhe vazhdum. Që ato një rryp, ose
19 nonji palë, nonji tojë, ose nonji diçka që kena pasë, që na i
20 kanë marrun kur na kanë çu, q'ato na i dhanë edhe tha
21 "Vazhdoni."

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës kam disa
23 pyetje, të cilat do të ishte mirë t'i bënim në seancë private
24 për ta mbrojtur dëshmitarin.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit znj. Prokurore.

1 Znj. Sekretare ju lutem të kalojmë në seancë private.

2 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës
4 jemi në seancë private.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit znj. Sekretare.

7 Znj. Prokurore mund të vazhdoni.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
9 Gjykatës.

10 Py. Zotëri, kush mbeti pas në stallë? A mund të na i
11 thoni tani emrat, meqenëse jemi në seancë private? Mund të na
12 i tregoni emrat e personave që u liruan dhe emrat e atyre që
13 mbetën pas, nëse ka mbetur njëri?

14 Pë. Po, znj. Prokurore. U lirova [REDAKTUAR]. Na

15 [REDAKTUAR] u lirum. [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR], ata mbetën brenda. Na u lirum, ata mbetën
17 brenda edhe thanë se këta i lirojnë më vonë.

18 Py. Ata personat të cilët ju liruan, a ju treguan, ju thanë
19 juve ndonjë gjë sepse personat e tjerë të mbetur më pas do
20 liroheshin më mbrapa jush? A ju dhanë ndonjë shpjegim lidhur
21 me këtë?

22 Pë. Po, na i pyetëm, se na veç mbetëm aty para asaj objektit
23 mbetëm aty pak. Edhe i thamë, "Pse s'po i lironi. Na po i
24 presim [REDAKTUAR] edhe këta." "Jo" tha, "Ata i lirojna ma
25 vonë," tha, "Ju vazhdoni," tha, "rrugën e ju." "Këta i

1 lirojna ma vonë" tha. Kështu na ka thonë ky [REDAKTUAR].
2 Py. Në rregull. A ju kujtohen kushtet ose le ta formulojmë
3 ndryshe. Në çfarë kushtesh ishte [REDAKTUAR] në atë pikë
4 n.q.s. ju kujtohet?
5 Pë. [REDAKTUAR] në atë pikë që e kena lanë na ditën e
6 fundit, ka qenë - mujt me thonë që as këmbët s'e kanë mbajt.
7 Ka qenë në gjendje të mjerushme. Ka qenë shumë, shumë i lodh,
8 i deformum shumë.
9 Py. Në rregull. Duke qenë se keni qenë atje dhe keni parë
10 gjërat në pikën e kohës kur u liruat ju. A e kuptuat juve, a
11 kishit ndonjë ide sepse [REDAKTUAR] nuk po lirohej me juve?
12 Pë. Jo, s'kishim ide kurrë, veç pyetjen që ia bëmë këtij
13 [REDAKTUAR], që na i pritshim edhe ata me liru. Tha, "Jo, ju
14 vazhdoni. Këta i lirojna ma vonë." Nuk kena pasë kurrë ma të
15 kjartë me ta, kurrë, veç kena vazhdu rrugën tonë.
16 Py. Në rregull. A mund të na thoni se ku shkuat pasi u larguat
17 nga ahuri?
18 Pë. Mbasi vazhduam rrugës, vazhduam me një rrugë që ashtu, ka
19 na thanë, që më shumë dhe ky [REDAKTUAR] pak na orientojke se
20 unë [REDAKTUAR]. Ai na orientojke ka pak edhe
21 vazhdum na rrugës ka na thojshin njerëzit kështu.
22 Py. Dhe t'i kthehem pak kushteve sepse juve na përshkruat
23 kushtet në të cilat gjendej [REDAKTUAR] atëherë kur ju dhe
24 personat e tjerë u liruan. Ju thatë, që së bashku me të ishte
25 edhe Burmaku; mbeti edhe [REDAKTUAR] bashkë me të. A ju

1 kujtohet se në çfarë gjendje ishte [REDAKTUAR] në atë pikë?
2 Pë. Po, [REDAKTUAR] u konë në gjendje të keqe sikur na edhe
3 ai, po [REDAKTUAR] a konë tmerr, tmerr asht ajo. Nuk di me
4 përshkru atë. Se edhe ky [REDAKTUAR] nuk ka qenë në gjendje të
5 mirë, as ky [REDAKTUAR], por. D.m.th. [REDAKTUAR] a kone
veçantë diçka
6 që s'mujt me e përshkru atë, s'mujt me merr me mend atë. Ato,
7 trupi i tij, ato dhimbjet e tijna, ajo, atë erën që kena ndi
8 na, atë erën e mishit, ajo a konë tmerr, a konë ajo. Ajo shumë
9 thjesht, shumë shkurt është, për mendimin tim është masakër.
10 Py. Në rregull. Faleminderit që na e sqaruat atë.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të kërkoj një këshillë
12 sepse kompjuteri më thotë që për një moment, për një minutë do
13 fiket. Dhe nuk e di çfarë duhet të bëj domethënë. U përpoqa që
14 të lëviz tastierën, dhe ndërkohë nuk munda të bëj dot asgjë.
15 Më ndihmon dot dikush ju lutem? Faleminderit.

16 Ndjesë të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo
18 nuk ka problem, më ndodh dhe mua ndonjëherë një gjë e tillë.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull atëherë, do e di se
20 çfarë duhet të bëj herën tjetër që të më ndodhë. Faleminderit.

21 Py. Z. Dëshmitar, ju thatë, që kur u larguat, [REDAKTUAR]
22 po ju tregonte rrugën, po drejtonte rrugën. A mund të na
23 thuash ju lutem se ku shkuat ju?

24 Pë. Po na vazhdum q'ashtu rrugës, edhe dolëm me një shtab
25 tjetër. Dhe ai vend u thirrke, Cërvadik, sa më ka mbetë në kry

1 ai emër, që e kom ndi aty prej njerëzve. U thirrke si Cërvadik
2 nji farë vendi. Aty kish qenë një shtab tjetër, dhe u ndalëm
3 aty. Bisedum me një komandant aty ose ku ta di unë çka ka qenë
4 ai aty. U mundum na me u ndal aty, po na tha që "S'keni ça me
5 u ndal. S'kem armë, s'kem kurrigjo. Vazhdoni ma mirë në shpijat
6 e juaj ose në rrugën e juaj."

7 Py. A e dini se kush ishte ky komandanti?

8 Pë. Sa më kujtohet mu, ky ish konë Fatmir Humolli a Havolli
9 nuk e di. Po ja qëto dy mbiemna njoni sa më ka mbetë mu në kry
10 ai. Emnin Fatmir e ka, po a asht a Havolli a Humolli nuk më
11 kujtohet besa.

12 Py. Dhe tani juve e mësuar emrin e tij sepse ai u prezantua, e
13 dëgjuat atje, d.m.th. nuk e di e mbani mend sesi e mësuar
14 emrin e këtij personi?

15 Pë. Po ai na është prezantuar si Fatmir Humolli a Havolli. U
16 prezantua edhe ajo kish qenë si shpi, diçka si shtab i tynve.
17 Kish pasë disa ushtarë aty. Na pyti se, "Prej nga po vini,
18 qysh?" Na i tregum ato edhe i thamë se, "A ka mundsi me u ndal
19 ktu, ndoshta mujna me kontribu naj send." Tha "Jo" se nuk keni
20 në punë kurrigjo, armë s'kem, kurrigjo s'kem, osht ofensivë."
21 Kështu tha, "Vazhdoni ma mirë nëpër shpijat juaj, ose ka të
22 mundni me pështu veten ma thjesht."

23 Py. Ju thatë që, ju i thatë atyre se nga po vinit. A e mban
24 mend ekzaktësisht se çfarë ju thatë juve atyre kur shkua tek
25 ky stafi?

1 Pë. Na i tregum. Ma shumë zakonisht folke ky [REDAKTUAR],
2 folke me ta. Se pak ma i vjetër edhe dike me fol. Na nuk
3 folshëm që aq veç ndejshëm. Ai na pyti tha, "Prej kah po
4 vini?" Na i kallzum që kështu, kështu, jena konë të burgosun.
5 I tregoi [REDAKTUAR] këto sendet. Bisedoi me ta dhe...
6 Py. A e mbani mend se cila ishte përgjigjja e tyre n.q.s. kur
7 ju dha përgjigjja. Përgjigjja iu dha nga komandant Fatmiri apo
8 nga dikush tjetër? A e mbani mend përgjigjen që ju dhanë ata
9 në momentin kur ju i thatë se çfarë kishte ndodhur?
10 Pë. Jo, valla. Ishte bash ky Fatmir Humolli. S'jam i sigurt
11 për mbiemrin a Humolli a Havolli, po ato që më ka mbetë në kry
12 nuk shlyhet. Ky Fatmiri personal me të bisedojke [REDAKTUAR].
13 Na ndigjoi shumë aty. Ushtarët e tij rrijshin q'aty afër
14 tijna. Ndigjojshin këto biseda. Ma thjesht iu vike keq. Nuk u
15 munojshin me të ngushëllu me një punë.
16 Py. A ju tregoi, a ju tha Fatmiri ju se çfarë roli kishte
17 ai?
18 Pë. Jo nuk e di çfarë roli ka pasë. Që pas asaj, ça mbaj mend,
19 ai kish qenë një komandant i atij shtabi, diçka aty, se nuk di
20 ma shumë për të.
21 Py. A e mbani mend se si quhej ky vend?
22 Pë. Ky vend i binte si - këta thejshin afër Cërvadikve, një
23 vend. Këto, që kjo Cërvadik nuk, më kujtohet, nuk mu ka fshi
24 prej kryesë. Ai farë territori u thirrke si Cërvadik q'ashtu,
25 q'ashtu i thojshin ata.

1 Py. Në rregull. Atëherë edhe një herë, me kë ishit juve në
2 këtë pikë kur ju arritët tek ky shtabi dhe kur ju kërkua që të
3 largoheshit? Ju përmendët [REDAKTUAR]. Po ndonjë njëri-tjetër
4 përveç [REDAKTUAR] a ishte me ju?

5 Pë. Isha me [REDAKTUAR].

6 Py. Dhe ku shkuaat pastaj?

7 Pë. Vazhdum te q'ai shtabi, vazhdum q'ashtu nëpër atë farë
8 pjese të katundit aty dhe dolëm në rrugë. Dolëm në rrugë
9 kryesore.

10 Py. Dhe prej aty nga shkuaat?

11 Pë. Dolëm në rrugë kryesore si një vend i binte Stallovë u
12 thirrke ajo vendi ku dolëm na aty, në atë asfaltin. Ku dolëm
13 aty pajshëm njerëzit t'u shku, shumë kalun. Edhe vazhdum edhe
14 na q'ashtu dalëngadale, tuj pushu tuj vazhdu shkum deri në
15 [REDAKTUAR] ça asht ajo. Se nuk po i di as vetë mirë
16 këto.

17 Py. Kur përmendët rrugën kryesore, a bëhet fjalë për rrugën
18 kryesore për ku?

19 Pë. Rrugën kryesore m'u lëshu për me shku për Prishtinë.

20 Py. Në rregull. Pra ju ecët në drejtim të Prishtinës. Ju
21 arritët në [REDAKTUAR]. A ju kujtohet n.q.s. ka pasur
22 ndonjë person tjetër i cili është bashkuar me juve rrugës për
23 në Prishtinë në ndonjë pikë të caktuar kohe?

24 Pë. Jo. Por kemi vazhdu q'ashtu drejt edhe kemi shku që ajo në
25 [REDAKTUAR] s'di si qysh thirret ajo vendi. Kemi pyt disa

- 1 gjin, kemi pyt disa njerëz se ku është kjo [REDAKTUAR]
- 2 edhe na orientun njerëzit tuj i pyt. Edhe shkum [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR].
- 4 Py. Çfarë bëtë atje? Me kë u takuat atje? Kë gjetët atje?
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 Py. E kuptoj. [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

1 Py. Në rregull. Ju thatë që [REDAKTUAR] u larguat diku nga
2 fundi i ditës, nga muzgu. Ku shkuat? D.m.th. shkuat bashkë a u
3 ndatë me njëri-tjetrin? Çfarë ndodhi më pas ku shkuat?

4 Pë. Po ne vazhdum, erdhëm në Prishtinë. Është një rrugë aty
5 [REDAKTUAR], thirret ajo rruga. [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR] unë në tjetrën pjesë. Aty u ndamë me të

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 Py. Dhe çfarë bëtë më pas [REDAKTUAR]?

10 Pë. Asgjë. [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 Py. Kam edhe disa pyetje të tjera lidhur me personat e tjerë
15 që janë mbajtur të ndaluar së bashku me ju dhe pastaj do
16 kalojmë në seancë të hapur.

17 Z. Dëshmitar, ju përmendët që [REDAKTUAR] mbeti në ahur së
18 bashku me [REDAKTUAR]. A e dini se çfarë i ka ndodhur

19 [REDAKTUAR]?

20 Pë. Jo, nuk di. Për [REDAKTUAR] nuk e di. [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR] mbas një kohe e kom marrë vesh se nuk jeton. Për
22 ata dy të tjerët nuk di.

23 Py. Në rregull atëherë. Pra unë e kuptoj që ju nuk jeni
24 takuar. Keni dëgjuar që [REDAKTUAR] ka vdekur, por që ju nuk e
25 keni takuar më pas këtij momenti, as [REDAKTUAR]. A është e

1 saktë kjo?

2 Pë. Po, po e saktë është. Nuk kam taku. [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 Py. Në rregull. Do ju bëj disa pyetje lidhur me [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]. Kur thoni [REDAKTUAR], e keni fjalën për

11 [REDAKTUAR] apo jo? Që ju përmendët si një ndër personat, i

12 cili u soll në stallë. A është kështu apo jo?

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

14 kërkoj ndjesë znj. Prokurore. Shikoj ca lëvizje në fund të

15 sallës dhe nuk e kuptoj drejtë se çfarë po ndodh. Nuk e di

16 n.q.s. mund të më informoni?

17 Nuk ka mikrofoni ndërkohë.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kam përshtypjen që reporterja

19 ka problem me monitorin dhe prandaj u ngrit.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e

21 kuptova se cila është arsyeja prandaj ndërhyra.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mendoj se mund të vazhdojmë.

23 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës

24 këshillohen]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si

1 udhëzim i përgjithshëm ose si informacion i përgjithshëm, ne
2 do të mundohemi që të organizohemi në mënyrë të tillë që të
3 mos ndodhë më në të ardhmen. Por për momentin mua mu tha që në
4 ekran, poshtë ekranit është një buton dhe duhet që ta shtypni
5 këtë butonin në mënyrë që mesazhi të hiqet. Besoj që mund ta
6 ndjeni me gisht n.q.s. shtypni butonin. Mirë pra në rregull.

7 Znj. Prokurore mund të vijoni më tej.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar.

9 Py. Atëherë, unë po pyesja n.q.s. [REDAKTUAR] që juve
10 përmendët ishte [REDAKTUAR] që ju thatë që në një pikë të
11 caktuar kohe u soll në ahër. Dhe ju thatë që e patë atë, por
12 që nuk keni folur me të, që nuk keni biseduar me të. A është e
13 saktë kjo?

14 Pë. Po e kam pa. E kom pa, nuk di. Ai u konë, qysh me spjegue,
15 e kom pa, [REDAKTUAR], ma thjesht punon.

16 Py. [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]. Për çfarë keni

18 biseduar me [REDAKTUAR] n.q.s. ju kujtohet?

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 Pë. Po ai nuk u soll me ndonjë anë kështu keq, po e kish

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 Pë. Po, po. Unë i tregova, i përmenda se i kallëzova

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 Py. Në rregull, e kuptoj. [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 Pë. Jo. [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 Py. Në rregull. Po lidhur me [REDAKTUAR], a e ke takuar

20 ndonjëherë tjetër [REDAKTUAR]?

21 Pë. Jo, [REDAKTUAR] se kom taku, s'kam dëgju kurrë për të

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull, faleminderit. Vetëm

23 pak sekonda ju lutem. Po shikoj n.q.s. ka ndonjë gjë tjetër që

24 dua t'ju pyes për momentin dhe që duhet të pyes në kuadër të

25 sesionit privat.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari W01679 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Znj. D'Ascoli
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 73

1 Mendoj se mund të kalojmë në seancë të hapur të nderuar
2 Gjykatës.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit znj. Prokurore.

5 Znj. Sekretare, ju lutem a mund të na ktheni sërish në
6 seancë të hapur.

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës
9 tani jemi në seancë të hapur.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit znj. Sekretare.

12 Znj. Prokurore, ju lutem vijoni më tej.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar
14 Gjykatës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa
16 për t'ju kujtuar znj. Prokurore, kemi vetëm pesë minuta të
17 mbetura nga kjo seancë. Jam e sigurt që ju e dini sesa është
18 ora por thjesht sa për t'ju kujtuar.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, faleminderit për kujtesën.

20 Py. Vetëm pak pyetje të tjera përpara se të bëjmë
21 pushimin e drekës.

22 Ju përmendët pjesën e poshtme të ndërtesës, apo atë
23 stallën aty ku jeni mbajtur. Përmendët gjithashtu edhe pjesën
24 e sipërme, dhomën sipër ku ju jeni dërguar në fillim fare të
25 marrjes suaj në pyetje kur mbërritët në atë vend, dhe kur jeni

1 dërguar edhe herë të tjera për rrahje.

2 Ju lutem a mund të na përshkruani se si shkonit juve nga
3 stalla deri tek pjesa e sipërme e ndërtesës, tek dhoma sipër?
4 Pë. Po prej sallës e çelshin derën, ta qitshin një farë
5 kapuçi, si thes, si, ta vejshin, kapuçin me krye ul q'kështu,
6 të çojshin kështu anash, të hypshin nalt, të shtijshin në
7 dhomë edhe fillonte ajo procedura e tyne.

8 Py. A ju duhej që të merrnit, t'i ngjiteshit shkallëve për të
9 shkuar tek pjesa e sipërme?

10 Pë. Po. Ka qenë tek hymja aty, kanë qenë nja dy shkallë, tri.
11 S'më kujtohen, veç ka pasë, po. Sa mbaj mend ka pasë shkallë.

12 Py. Këto shkallët ishin shkallë të brendshme apo shkallë të
13 jashtme në ndërtesë?

14 Pë. Jo, të jashtme. Para hyrjes. Të jashtme.

15 Py. Në rregull. Pra ju nxirreshit nga salla, nxirreshit
16 jashtë, pastaj merrnit ca shkallë të jashtme, të cilat ju
17 çonin tek kjo pjesa e ndërtesës që ishte sipër, në katin
18 sipër. A është e saktë përmbledhja që sapo bëra?

19 Pë. Po ashtu ka pasë shkallët. I ka pasë para hyrjes i ka pasë
20 do shkallë. Ne na marrshin prej stallës na çojshin, ka qenë si
21 livadh, si tokë pak si e naltë. Na çojshin këtu, janë konë
22 shkallët, na shtijshin mrena aty. Para hymjes janë konë ato
23 shkallë.

24 Py. Në rregull, faleminderit.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë kam

1 një grup pyetjesh, të cilat më mirë do të ishte që të bëheshin
2 së bashku, që kështu do sugjeroja që n.q.s. nuk e keni problem
3 ta ndërprisnim këtu seancën e paradites edhe të bëjmë pushimin
4 e drekës.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit znj. Prokurore. Ne do të vijojmë siç propozuat
7 ju.

8 Ka ardhur koha për pushimin e drekës. Ne do të
9 rimblidhemi sërish në orën 14.00.

10 Z. Dëshmitar, ne do të takohemi sërish pas një ore
11 bashkë. Shpresoj që të pushoni paksa, pas këtyre momenteve
12 intensive të dhënies së dëshmisë këtu në sallë. Ju kërkoj
13 ndjesë për problemet e vogla teknike që patëm dhe për
14 ndërprerjen e seancës dhe dua t'ju falënderoj për durimin tuaj
15 në këtë aspekt.

16 Atëherë siç u komunikua nga java që shkoi, seanca e ditës
17 së sotme do të jetë nga ora 2 deri në orën 3. Pra do të jetë
18 vetëm për një orë dhe pastaj do të vazhdojmë sërish dëshminë
19 tuaj ditën e nesërme, pra, nesër.

20 Atëherë znj. Sekretare nuk e di n.q.s. mund ta shoqëroni
21 dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
24 atëherë do të shihemi sërish në orën 2.

25 Seanca e paradites mbyllet këtu.

1 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00 pasdite

2 --- Seanca rifillon në orën 14.02 pasdite

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
4 lutem zini vend.

5 Mirë se erdhët sërish. Ne do të vazhdojmë me dëshminë e
6 dëshmitarit W01679, por jo përpara sesa të bëj një kontroll
7 për të parë se të gjitha gjërat janë siç duhet dhe në qoftë se
8 skuadrat janë ashtu siç ishin edhe përpara se të bënim
9 pushimin. Shikoj që kemi të njëjtit persona në sallë ashtu siç
10 ishit edhe paradite. Pra shoh gjithashtu edhe zotin Mustafa.

11 Ne do të diskutojmë në fund të këtij takimi - nuk do të
12 diskutojmë në fakt po thjesht do ta hedhim për procesverbal,
13 pesë minutat e fundit sepse sot në fakt duam që të respektojmë
14 orën dhe neve pamë pesë minuta përpara orës 3, një email që më
15 ka ardhur nga Zyra e ZPS-së, gjë të cilën do të doja ta
16 diskutoja pak më shumë nesër se sot nuk kemi shumë kohë. Po
17 domethënë thjeshtë sa për procesverbal doja që ta përmendja
18 këtë gjë. Pra do e diskutojmë nesër emailin e ardhur nga ZPS-
19 ja.

20 Atëherë, zonja Sekretare a mund ta shoqëroni Dëshmitarin
21 në sallë ju lutem?

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 Mirëdita, z. Dëshmitar. Më dëgjon mirë mua?

24 DËSHMITARI: Po, znj. Gjykatëse.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

1 mirë. Tani, do t'ia jap sërish fjalën Prokurorisë, në mënyrë
2 që të mund të vijohet më tej me pyetjen tuaj. Në rregull?

3 Znj. Prokurore fjala për juve.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
5 Gjykatës.

6 PY. Z. Dëshmitar, përpara pushimit, juve na përshkruat sesi
7 ju merrnin nga stalla, nga ahri, aty ku ishit dhe ju dërgonin
8 tek ajo pjesa e sipërme e ndërtesës, që juve e përmendët si
9 pjesa e sipërme e ndërtesës dhe na thatë që do hipnit shkallët
10 në pjesën e jashtme për të shkuar te kjo dhoma sipër. A ishte
11 kështu? E mban mend që e thatë këtë gjë?

12 PË. Po, znj. Prokurore.

13 PY. Në rregull. A mund të na përshkruani këtë pjesën e
14 sipërme të ndërtesës, këtë pjesë të ndërtesës ku juve ju
15 dërguan në fillim fare për të marrë në pyetje nga [REDAKTUAR]
16 [REDAKTUAR] dhe pastaj për t'ju rrahur gjatë ditëve të tjera
17 në vijim, siç na treguat gjatë paradites. Ju lutem, a mund të
18 na përshkruani sesi ishte kjo pjesa brenda, kjo dhoma brenda?

19 PË. Po, sa e mbaj mend ka qenë si lloj korridori në anën e
20 majtë. Neve na shtijshin në këtë dhomën në anë e majtë që na
21 pyetshin dhe që na torturojshin a sene. A kanë ana e majtë, ka
22 kemi hi ana e majtë. Po në këtë pjesën, në këtë anë ka pasë
23 derë tjetër po çka ka qenë, nuk di.

24 PY. Në rregull. A mund të na përshkruani këtë dhomën ku u
25 dërguat ju brenda, domethënë si ishte brenda dhomës, çfarë

1 kishte brenda, çfarë pamje kishte, çfarëdolloj gjëje që ti
2 mund të kujtosh lidhur me këtë dhomë?

3 PË. Ka pasë ndonjë karrige, ndonjë si bankë shkolle diçka, ka
4 pasë disa, si me thënë, si rafte atyrve diçka po poshtë ka
5 qenë si dërrasa, na i thojmë si lloj lllamperie i thojmë
6 q'ashtu diçka. I kam pa unë ato do farë sikur kaseta të tyre
7 për ato gjerat e veta, ku ta di unë. Se dhe nuk ke mujtë me
8 këqyrë në q'aq aty brenda se s'ke pas edhe kohë ndoshta me
9 këqyrë ose s'të kanë interesu me këqyrë qaq.

10 PY. Kur më herët na përshkruat maltratimet, keqtrajtimet që
11 pësuar, juve përmendët një serë elementësh të cilat u përdorën
12 si p.sh., shufra apo kjo kutia e rrymës, apo qirinjtë. Këto
13 gjëra, a ishin aty brenda dhomës?

14 PË. Po, po në atë dhomë kanë qenë këto, krejt këto sende. Çka
15 ka ndodhë, këto kanë qenë në q'atë dhomë.

16 PY. Tani çfarë mund të thoni për stallën? Për ahrin aty ku
17 jeni mbajtur? Ju e përshkruat atë si një vend ku mbaheshin
18 kafshët, si një stallë, thatë. A kishte, në fakt, kafshë aty
19 së bashku me ju dhe personat e tjerë?

20 PË. Jo, kafshë nuk ka pasë. Po ajo u shike që është stallë e
21 kafshëve. Shihet ajo se na kena pa dhe ma herët aty ku i
22 mbajnë lopët e këto gjëra. Ajo dhe u kuptojke ajo që është
23 stallë e lopëve.

24 PY. Kjo stalla, a ishte e mbyllur?

25 PË. Po, e mbyllur ishte. Një derë e drunit me hi q'aty ku

1 jena dalë tjetër send nuk kam vërejtë përpos disa drunave që i
2 thojmë na traj u thojmë atyne.

3 PY. Dhe a ishte me roje aty me aq sa mund të tregoni juve? A
4 ruhej ai vendi aty?

5 PË. Po rojet i ke pasë te dera jashtë aty. I ke pasë rojet
6 non-stop.

7 PY. Në qoftë se dëshironit juve, a mund të dilnit nga ajo
8 stalla ku ishit?

9 PË. Jo. Jo, jo ka qenë e mbyllme aty. Ka qenë me ato
10 zinxhirët me ato çka e lidhshin këta. [Me] sa më kujtohet aty
11 s'ke mujt me dalë se aty i ke pasë para dere e ke pasë rojën
12 non-stop edhe, me shkurt, aty edhe me guxu me dalë pi aty s'ke
13 mujtë ka edhe me dashtë domethënë.

14 PY. Z. Dëshmitar, tani do t'ju tregoj disa fotografi.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem, a mund të
16 tregoni në ekran dokumentin në nënndarjen 10 në listën e
17 provave materiale për këtë dëshmitar me numër identifikimi ERN
18 SPOE00128386 deri në 00128420. Dua që të tregoni faqen tre, ju
19 lutem.

20 PY. Z. Dëshmitar, a e shikoni dot fotografinë që është
21 shfaqur në ekran?

22 PË. Po, znj. Prokurore.

23 PY. A ju duket i njohur ky vendi i cili tregohet në
24 fotografi?

25 PË. Po, sa më kujtohet mu, kështu ka qenë. Kjo është. Kjo

1 duhet me qenë, sipas mendimit, ajo ça më ka mbetë ajo pamja,
2 ajo fotografi. Kur jena liru që e kam pa, kjo duhet me kanë.
3 PY. Çfarë do të thuash kur thua "q'ai vend"?

4 PË. Po i përngjan shumë asaj pamjes që më ka mbetë mu kur jam
5 liru. Kur e kam pa kështu shumë ngjan edhe shembull edhe është
6 podrumi poshtë edhe është kjo pjesa, që po them, kur na
7 merrshin na çojshin naltë edhe shumë ngjan shumë me atë
8 objekt. Ngjan, mu më duket i ngjajshëm kështu diçka.

9 PY. Z. Dëshmitar, në fakt, ju keni identifikuar dhe shënjuar
10 ndërtesën ku jeni mbajtur, në intervistën që keni pasur me
11 ZPS-në më [REDAKTUAR].

12 A e mbani mend këtë?

13 PË. Po.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë të nderuar
15 Gjykatës, se nuk e dëgjova përkthimin.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Atëherë do i kërkoj edhe njëherë znj. Prokurore që të
18 përsërisë pyetjen dhe pastaj Dëshmitari mund të përsërisë
19 përgjigjen e dhënë.

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, patjetër.

21 Zotëri, në fakt, ju keni identifikuar dhe keni shënuar
22 ndërtesën ku ju jeni mbajtur në një intervistë që keni kryer
23 me Zyrën e Prokurorit të Specializuar më [REDAKTUAR]. Kjo
24 është pyetja që unë bërë pak më përpara. A e mbani mend këtë
25 gjë?

1 PË. Po, po i kam pa disa fotografi. Mua ajo ça më ka ngja mas
2 shumti jam mundu me nënvijëzu, po.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani, do t'i kërkoj Sekretares
4 që të na tregojë një tjetër fotografi dhe ta vendosë ngjitur
5 me fotografinë që kemi aktualisht në ekran.

6 Ju lutem, a mund të tregoni dokumentin me identifikimin
7 ERN 10081 deri në 10086 RED dhe do të doja dokumentin në faqen
8 tre. Ndërkohë që dua të specifikoj që ky dokument është pjesë
9 e nënndarjes së tetë të listës së provave materiale për këtë
10 dëshmitar. Unë dua që të shfaqet dokumenti me numrin e
11 identifikimit 100803.

12 Zotëri, a mund t'i shihni qartë të dy fotografitë në
13 ekran?

14 PË. Po, znj. Prokurore, po.

15 PY. Në qoftë se do të shikoni fotografinë e cila është në të
16 majtën tuaj, a vini re aty një datë dhe nënshkrim në këtë
17 fotografi? Është në cep fare në të majtë të ekranit.

18 PË. Po. Po, po shihet kjo.

19 PY. A e njihni nënshkrimin në të majtë të fotografisë?

20 PË. Po, ma merr mendja që është i jemi.

21 PY. Tani, në qoftë se do të shohim fotografinë në të majtë,
22 është një ndërtesë aty e cila është e rrethuar me stilolaps me
23 ngjyrë të kuqe dhe është përcaktuar një numër, është numri një
24 aty. A mund të na tregoni, ju lutem, se çfarë keni rrethuar?
25 Pra, cila ishte kjo ndërtesa që ju keni rrethuar në të majtë

1 të fotografisë?

2 PË. Po ky numri një, kam mëndu me jua spjegu se numri një
3 është këtu poshtë ku jena mbajtë edhe me këtë me këto vija jam
4 mundu me tregu se këtu naltë, domethënë, na kanë maltratuë na
5 kanë pyetë, na kanë...

6 PY. Pra, ju keni rrethuar ndërtesën, ku në ahër jeni mbajtur
7 dhe në pjesën e sipërme jeni marrë në pyetje dhe jeni rrahur.
8 E kam të saktë këtë?

9 PË. Po, znj. Prokurore, po. Ashtu jam mundu me spjegu unë me
10 këtë njëshin me këtu.

11 PY. Në rregull. Tani më lejoni t'ju tregoj një tjetër
12 fotografi.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është një fotografi nga i
14 njëjti grup dokumentesh apo fotografish, është faqja shtatë,
15 nga dokumenti SPOE00128392. Dhe, ju lutem, hiqni nga ekrani
16 fotografinë e shënuar në krahë të majtë të saj.

17 PY. A mund ta shikoni qartë fotografinë në ekranin e
18 kompjuterit para jush?

19 PË. [E padëgjueshme].

20 PY. A e keni parë më përpara këtë ndërtesë?

21 PË. Po. Mu më duket si e ngjajshme ajo edhe me atë, edhe me
22 fotografinë e parë, po domethënë, tek kjo fotografi janë
23 fokusu ma shumë, se janë fokusu se edhe kjo është i njëjti sen
24 e ka poshtë atë ahrin. E ka qaty si te naltë, që u mundova me
25 jua tregu, i ka shkallët edhe ngjan shumë me atë objekt.

1 PY. A mund të na thoni se në cilën anë të fotografisë është
2 pjesa e poshtme ku gjendet ahri dhe po lexoj nga përgjigja që
3 keni dhënë juve, a është pjesa në të majtën tuaj apo është
4 pjesa në të djathtën tuaj?

5 PË. Jo, pjesa e ahrit është në pjesën e majtë, e këtij
6 pozicioni në pjesën e majtë, domethënë, shihet këtu pak ma
7 qartë poshtë.

8 PY. Në fakt, edhe njëherë, ju keni identifikuar dhe keni
9 shënjuar ndërtesën ku jeni mbajtur në të njëjtën intervistë me
10 ZPS-në më [REDAKTUAR].

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Znj. Sekretare, do t'ju kërkoja
12 sërish që të tregonit një fotografi të dytë ngjitur me këtë
13 foto që është dokumenti, i cili unë ju kërkoja që ta shfaqnit
14 pak më parë, që është me numrin tetë në listën e provave
15 materiale ndërkohë që numri i identifikimit është ERN 100801
16 deri në 100806. Kësaj here, do ju kërkoja që të shfaqnit faqen
17 pesë, me numër identifikimi 100805.

18 PY. Z. Dëshmitar, a i sheh dot dy fotografitë në ekran?

19 PË. Po, znj. Prokurore.

20 PY. A e shihni datën dhe nënshkrimin në fotografi në të majtë
21 të ekranit?

22 PË. Po, znj. Prokurore. Po shihet, pak a shumë.

23 PY. E kujt është kjo firmë, ky nënshkrim?

24 PË. E imja është.

25 PY. Tani, në qoftë se shohim nën nënshkrimin tuaj, vëmë re që

1 kemi një numër këtu, është numri një, i shkruar. A mund të na
2 tregoni se cilën pjesë të ndërtesës keni shënjuar me numrin
3 një.

4 PË. Jam mundu me shënu këtë pjesën e ahrit ku kena qëndru na
5 me numrin një.

6 PY. Në rregull. Në qoftë se do të shihni sipër, drejt çatisë
7 së ndërtesës është shifra dy aty e shënjuar. A mund të na
8 thoni, ju lutem, se çfarë tregon numri dy, domethënë, cilës
9 pjese të ndërtesës i referohet numri dy?

10 PË. Po. Ke numri dy, jam mundu me shpjegu, se ky njëshi kena
11 qëndru aty, numri dy është naltë ku na kanë çu me na maltratu
12 apo me na diçka, është numri dy pjesa naltë. Për një ahër
13 është kjo. Ajo pjesa ku aty ku na kanë torturu. Atë jam mundu
14 me këtë numrin dy me sqaru.

15 PY. Dhe, a e shihni dot derën që është në mes të ndërtesës?

16 PË. Po.

17 PY. Dera, në fakt është më mirë e dukshme, mund ta shohësh më
18 lehtë në fotografinë tjetër. Kjo është një derë që ka disa
19 shkallë përpara. A ju kujtohet kjo pamje?

20 PË. Po dhe për q'atë ma kanë -- mu ka kujtu se këto shkallë
21 kur të kanë marrë prej poshtit me çun altë. Tani e di që janë
22 kanë do shkallë duhet me i kalu me hy brenda. Këto shkallë më
23 kujtojnë.

24 PY. Në rregull. Pra, kjo ishte dera me këto shkallët nga
25 jashtë që ti na përshkrove që shërbente për t'u futur te dhoma

1 sipër. A është e saktë kjo që thashë unë përshkrimi im?

2 PË. Po, znj. Prokurore, kështu jam mundu me shpjegu këtë send
3 kështu qysh po shihet.

4 PY. Në rregull.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Atëherë të dyja fotot mund të
6 hiqen nga ekrani.

7 PY. Tani do t'ju tregoj një fotografi tjetër.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të shikohet nëndarja 11
9 e listës së provave materiale. Numri i identifikimit është ERN
10 00031 deri në 00031RED.

11 PY. Zotëri, a e shihni dot fotografinë e shfaqur në ekranin e
12 kompjuterit para jush?

13 PË. Po, znj. Prokurore.

14 PY. Ndërtesa ose fotografia, a ju duket e njohur apo, e thënë
15 me fjalë të tjera, çfarë dalloni në këtë fotografi?

16 PË. Po në këtë foto, tash nuk po di a është saktë ajo është
17 shtëpi, po në këtë foto kisha mujt me dallu veç këtë që është
18 si te naltë, ato shkallë, kisha mujt me dallu dhe këtë
19 objektin tjetër se sa e kam pa unë ka pasë edhe objekte të
20 tjera aty.

21 PY. Pra, kur thoni pjesa e sipërme dhe shkallët, ai
22 referoheni, e keni fjalën për të njëjtën ndërtesë që pamë në
23 fotografinë që u shfaq më parë?

24 PË. Po, ashtu. Ajo ça më ka mbetë në kry, më kanë mbetë krejt
25 kjo te naltë e ato shkallë, e këto sende ça më kanë mbetë

1 kujtime, ashtu i veçoj këto sende në këtë farë territori në
2 këtë objekt.

3 PY. Po ashtu dua të kërkoj që të shfaqet e njëjta fotografi
4 që keni shënjuar në intervistën me ZPS-në.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është numri identifikues si më
6 përpara, është nëndarja tetë, dokumenti me numër reference
7 ERN 100801 deri në 100806 dhe dua që të shfaqet faqja numër
8 gjashtë. Ju lutem, vendosini të dy fotografitë ngjitur me
9 njëra-tjetrën.

10 PY. Zotëri, a mund t'i shihni të dyja fotot që janë shfaqur
11 në ekran tani?

12 PË. Po, znj. Prokurore.

13 PY. A e shihni datën dhe nënshkrimin në fotografinë që jepet
14 në të majtë të ekranit?

15 PË. Po, znj. Prokurore.

16 PY. I kujt është ky nënshkrim?

17 PË. Është nënshkrimi im.

18 PY. Tani në këtë fotografi, mbi nënshkrimin tuaj, është
19 shkruar një numër 1 dhe ka dhe një vijë që nuk shihet shumë
20 qartë. Pra, është një vijë që përshkruan ndërtesën dhe pastaj
21 vjen numri një. Çfarë donit të tregonit ju me numrin një?
22 Është në të majtë të fotografisë.

23 PË. Po, znj. Prokurore. Ky njëshi kam deshtë me spjegu apat
24 të njëjtin send se ky njëshi është ai vendqëndrimi jonë ku
25 kemi ndejtë në atë ahrin.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mund të hiqen fotografitë. Ju
2 faleminderit.

3 PY. Z. dëshmitar do të të tregoj edhe një fotografi tjetër.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem, paraqisni faqen 27,
5 të dokumentit ERN SPOE00128386 deri në faqen 00128420, që
6 është dokumenti në nënndarjen 10 të listës së dokumenteve.
7 Faqja 27 me numër SPO00128412.

8 PY. Zotëri, të lutem, shihe këtë fotografi që ke aty përpara.
9 E dallon mirë?

10 PË. Po, zonjë.

11 PY. E njeh këtë ndërtesën? Të duket e njohur?

12 PË. Muj ndoshta me thënë më duket e njofshme ky objekt, nëse
13 s'gaboj, kjo duhet me kanë shkolla ku unë jam lajmëru këtu,
14 nëse nuk gaboj. Kështu ka qenë objekt një shkollë, nëse
15 s'gaboj, kjo mundet me kanë ajo shkolla. Sipas mendimit tim.

16 PY. Pra, na the shkolla ku shkove të raportoje. Aty e ke bërë
17 dhe trajnimin për të cilin na fole sot në fillim të dëshmisë?

18 PË. Po, nëse është kjo, nuk jam i sigurtë shumë, po kështu ka
19 qenë një lloj objekti kështu si shkollë. Këtu, kjo duhet me
20 qenë ajo ku kam ndejtë ato katër-pesë ditë edhe ku kam ndejtë,
21 ku kam bë ushtrime, ku këto sende.

22 PY. Dhe na the që kjo ndërtesa e dytë, ky objekti i dytë ku
23 ndenje, ku u trajnove, është shkolla; kështu ka qenë?

24 PË. Ashtu ma merr mendja, sa mbaj mend unë, kështu ka qenë
25 diçka.

1 PY. Tani do të tregojmë një foto tjetër dhe përsëri do të të
2 pyes nëse e njeh këtë objekt.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është dokumenti me numër 31. Më
4 fal., nëndarja 12 në listën e provave materiale dhe numri
5 është SPOE00287803 deri në 00287803.

6 PY. Zotëri, e shih atë foton aty përpara?

7 PË. Po, zonjë.

8 PY. A njeh diçka këtu? Si të thashë, është marrë kohët e
9 fundit, në fakt, sigurish, koha ka bërë të vetën në këtë
10 objekt. Por, a të kujtohet gjë duke e parë?

11 PË. Po tash s'po muj me thënë diçka që më kujton po.

12 Faktikisht, kështu ka qenë objekti ku jena lajmëru. Ajo e para
13 ke ma më e ngjajshme, pak ma e ngjajshme. Po ka kalu shumë
14 kohë e gjatë edhe nuk po muj me thënë një arsye, një diçka.
15 S'po më kujtohet.

16 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mund ta hiqni fotografinë tani,
18 ju lutem.

19 Të nderuar Gjykatës, kam edhe nja dy pyetje, të cilat
20 mund të nxjerrin hollësitë e dëshmitarit të mbrojtur, për këtë
21 arsye kërkoj të futemi në seancë private për pak.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
23 rregull, znj. Prokurore.

24 Sekretare, të lutem, na fusni në seancë private.

25 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Znj. Prokurore, mund të vijoni me pyetjet.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderur

6 Gjykatës.

7 PY. Z. dëshmitar, përpara pushimit të pyeta lidhur me kushtet
8 ku ti i pe ata, të ndaluarit, kur ty të liruan, ata që le pas
9 dhe të pyeta për njërin prej tyre që quhet [REDAKTUAR]. E
10 mban mend këtë pyetje që të bëra?

11 PË. Po, znj. Prokurore.

12 PY. Në faqen 55, rreshtat 10 deri në 14, në përgjigjen që dhe
13 për pyetjen që të bëra, në ç'gjendje e le [REDAKTUAR] ke
14 thënë:

15 "[REDAKTUAR], kur ne u larguam, atë ditën e fundit, si
16 ta them, ishte -- nuk rrinte dot në këmbë. Ishte në një
17 gjendje të tmerrshme. Dukej shumë i lodhur, i dërrmuar, i
18 deformuar".

19 Kjo është përgjigja që ke dhënë ti sapo e lexova nga
20 fjalët e shkruajtura aty.

21 Tani, pyetja që kam është kjo: The që nuk rrinte dot as
22 në këmbë, por a mund të ecte? Ecte dot me këmbët e veta?

23 PË. S'di ç'a me thënë. Po në atë pjesë a kanë shumë, shumë i
24 lodhun, i dërrmum edhe kohën e fundit veç në tokë ka ndejtë.
25 Nuk ka ndejtë kështu që, me thënë, me u çu ose diçka. Nuk ma

1 merr mendja që pa e ndihmu na një kush që kish mujtë edhe me
2 ec.

3 PY. Në rregull.

4 Më duhen dhe pak minuta për t'u siguruar nëse kam diçka
5 tjetër për seancë private.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Vazhdoni.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Besoj që mund të kalojmë në
9 seancë të hapur, të nderuar Gjykatës dhe kam edhe disa pyetje,
10 pak pyetje që më kanë mbetur.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull znj. Prokurore.

13 Sekretare, të lutem, të kalojmë përsëri në seancë
14 publike.

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit.

19 Mund të vazhdoni znj. Prokurore.

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
21 Gjykatës.

22 PY. Z. Dëshmitar, tani do të kalojmë tek pyetjet e fundit që
23 kam për ju.

24 A mund të na thuash se çfarë pasojash ke vuajtur nga ato
25 që të ndodhën aty ku të kishin mbajtur të burgosur?

1 PË. Po pasoja kam që i barti edhe sot. Edhe sot jam i sosun
2 në dorë, i premë pak në krahë, [REDAKTUAR], domethënë,
3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]. Ka shumë gjena që i barti dhe sot, përveç atyre
5 mavijosje, atyne sendeve ça janë shëru, ka gjena që i barti
6 dhe sot, fatkeqësisht.

7 PY. Mbase të liruan, a shkove ke ndonjë mjek me u mjeku?

8 PË. Kam shku mbase një kohe mbase nja, muj me thënë, ashtu
9 mbase nja tre muaj, kam shku e kam pasë një operim për në gojë
10 e kam pasë një operim prej infeksionit edhe kam shku ndërkohë
11 nëpër mjekë. Kam vizitu mjekë shumë.

12 PY. Dhe këto ishin si pasojë e maltratimit që të bënë aty kur
13 të mbajtur të burgosur?

14 PË. Po, sipas e tyne, se këto janë kanë shumë në rregull, jam
15 kanë si një fëmijë normal. Po, fatkeqësisht, këta njerëz, këta
16 individë mi bënë këto sende e më prunën në atë gjendje.

17 PY. Çfarë gjurmësh të la e gjithë kjo gjatë muajve, viteve që
18 kaluan mbase u lirove?

19 PË. Më ka lënë lloj-lloj gjurme, lloj-lloj. Unë edhe sot nuk
20 muj as me flejtë, as nuk muj me rehatu shpirtin tim. Boll
21 është veç ëndërr kur i sheh ose kur i ndin ato zëna ose ato
22 sende për mu është shumë. Përpos këtyne pjesëve që i bart edhe
23 sot këto pasoja, kam shumë probleme kam.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përthim] Të nderuar Gjykatës, këto ishin
25 pyetjet e mia. Nuk kam pyetje të tjera për këtë dëshmitar.

1 Faleminderit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit znj. Prokurore.

4 Z. Dëshmitar, për sot dua të të falënderoj shumë. Pyetjet
5 që ishin për ty sot mbaruan. Por më lejo të të kujtoj se deri
6 nesër nuk duhet ta diskutosh dëshminë tënde me askënd. Dakord?

7 DËSHMITARI: Në rregull.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani,
9 do të ndihmojë stafi i Administratës, përpigu të pushosh dhe
10 do të shihemi përsëri nesër në orën 09:30.

11 DËSHMITARI: Në rregull. Faleminderit shumë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Sekretare, të lutem, shoqëroje dëshmitarin të dali nga salla.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
16 prokurore, kemi marrë një email nga ZPS-ja dhe po të jap
17 fjalën të thuash diçka. Dua të them gjithashtu se kemi marrë
18 një email nga Avokatja e Viktimave.

19 Nuk dua të marr vendim tani, për momentin, por për
20 procesverbal keni fjalën. Sot jemi të detyruar nga koha, nuk
21 bëjmë dot gjë.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do të flasë shumë shkurt.

23 Për ta vënë në procesverbal, duke pasur parasysh ritmin e
24 dhënies së dëshmisë gjatë pyetjeve tona të drejtpërdrejta, e
25 kemi rishikuar vlerësimin tonë për pyetjet që kishim ndërmend

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 të bënim dhe kjo ka të bëj me dy dëshmitarë që ishin
2 parashikuar për pjesën tjetër të tetorit, dëshmitari W3094 dhe
3 W4603. Kështu që, në vend të gjashtë orëve që kishim menduar
4 fillimisht se do të vazhdonim rastin e dëshmitarit të parë,
5 menduam që mund t'i përfundojmë pyetjet brenda katër-pesë
6 orëve. Për dëshmitarin e dytë, për të cilin, fillimisht
7 menduam se do të vazhdonim pesë orë, mendojmë se mund t'i
8 përfundojmë maksimumi brenda dy orëve.

9 Pra, duke pasur parasysh se këto ndikojnë në planin e
10 punës së palëve të tjera dhe të Trupit Gjykses, dëshironim
11 t'ju njoftojmë paraprakisht.

12 Përveç kësaj, do të bëjmë të njëjtën gjë, dua të them,
13 t'ju dërgojmë vlerësime të rishikuara për dëshmitarët e
14 parashikuar të vijnë në nëntor. Këtë do ta bëjmë përmes një
15 urdhër të përditësuar të dëshmitarëve që planifikojmë të
16 thërresim në nëntor.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit, znj. Prokurore.

19 Do t'i kthehem përsëri kësaj çështjeje nesër në mëngjes,
20 në qoftë se është e nevojshme edhe palët e tjera, sigurisht,
21 mund ta marrin fjalën për këtë çështje.

22 Diçka desha të thosha në emër të Trupit Gjykses. Edhe ne,
23 si Trup Gjykses, duhet të përgatitemi për dëshmitarët, pra nuk
24 është në diskutim, nuk ka rëndësi vetëm koha e pyetjeve por
25 edhe koha që na duhet ne për t'u përgatitur sepse çështja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [është] më komplekse, po.

2 Ka ndonjë gjë tjetër që palët dhe Avokatja e Viktimave
3 dëshiron të ngrejë në këtë moment?

4 Z. PUES: [Përkthim] Duke pasë=ur parasysh kohën shumë
5 shkurt. Ne vumë në dukje një farë fleksibiliteti lidhur me
6 disponueshmërinë dhe këtë e kemi shprehur me shkrim, në qoftë
7 se planifikohen dy dëshmitarë javën që vjen, bashkë me kolegët
8 e tjerë, ne do të bëjmë çmos që të jemi të pranishëm.

9 Faleminderit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka
11 diçka që Mbrojtësit dëshirojnë ta ngrenë në këtë moment?

12 Z. VAN BONE: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, nuk kemi
13 gjë për të ngritur në këtë moment.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull.

16 I falënderoj palët dhe Avokatin e Viktimave për praninë.
17 Falënderoj përkthyesit, që duhet të vazhdojnë edhe një seancë
18 tjetër sot që fillon në 15.30, teknikët, ishte pak e vështirë
19 sot dhe personelin e sigurisë për ndihmën e tyre.

20 Këtu përfundon seanca sot dhe takohemi nesër në 09.30.

21 --- Seanca mbyllet në orën 14.49 pasdite

22

23

24

25